



Bankieri

Botim Nr. 36
Korrik 2020

ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE



NGA MBYLLJA DREJT HAPJES



Vetëm për 3 muajt e parë
të shtyries së kësteve,
industria bankare rriti
likuiditetin në duart e
huamarrësve me
75 milionë Euro



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

ANËTARËT E AAB-së



ALPHA BANK



AMERICAN BANK
OF INVESTMENTS



BANKA KOMBËTARE TREGTARE



CREDINS bank



Fibank
First Investment Bank



INTESA SANPAOLO BANK
Albania



otpbank



ProCredit Bank



Raiffeisen
BANK



TIRANA BANK



UNIONBANK



UBA
Banka e Bashkuar
e Shqiptarisë
United Bank
of Albania

PËRMBAJTJA

Bankieri

Nr. 36, Korrik 2020

Botim i Shoqatës Shqiptare të Bankave



REDAKSIA:

Elvin Meka

Kryeredaktor

Eftali Peçi

Koordinatorë

Dorina Zarka

Fotografe**Design & Layout:** FCB AfirmaShtypi nga:  Gent-grafik

Bankieri është publikimi zyrtar i Shoqatës Shqiptare të Bankave i cili i dedikohet kryesisht sektorit bankar shqiptar. **Bankieri** i jep lexuesit një informacion të vlefshëm mbi arritjet e industrisë në përgjithësi dhe të bankave tregtare në veçanti.

SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Rr. Ibrahim Rugova,

SKY TOWER, 9/3, Tiranë

Tel: +355 4 2280371/2

Fax: +355 4 2280 359

www.aab.al

Editorial

Nga mbyllja në hapje: rruga drejt krijimit të besimit

Prof. Asoc. Dr. Elvin MEKA

5

Tema e Ditës

Sfidat e sipërmarrjes dhe ndihma qeveritare, gjatë pandemisë Covid-19

Eduard SHALSI, Ministër

6

Politika monetare si instrument kontrolli monetar dhe stabilizimi ekonomik

Erald THEMELI

8

Bankat në përpjekje për një ri-ngritje dhe rritje të fortë

Burçak INEL

11

COVID 19 – HAPJA

Dr. Spiro BRUMBULLI

13

Bankat përballë COVID-19

16

Intervista

AMF – Drejtimi i ri për sfidat aktuale dhe ato në vijim

Ervin METE

24

Sistemi Bankar

Bankat e të ardhmes: sfidat, vizioni dhe strategjitë

Prof. Dr. Adrian CIVICI

26

Shkëmbimi automatik i informacionit - Çfarë nënkupton për Shqipërinë dhe bankat shqiptare?

Enkeleja TOTO

29

TIK - një nga elementët thelbësorë në tejkalimin me sukses të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19

Alketa LAMÇE

31

Sfidat e Auditimit të Brendshëm gjatë krizës Covid-19

Dorida STAMBOLLA

33

Forumi i Ekspertëve

Përtej Covid –19: Mundësi të reja për sektorin e FinTech-ut shqiptar

Jonida KËLLEZI

36

Trajnimet - sfidat dhe mundësitë në kushtet e pandemisë

Junida TAJAJ

39

Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm

AAB: Aktivitete - Trajtime

44

BORDI EDITORIAL:

Silvio PEDRAZZI

Kryetar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm, Intesa Sanpaolo Bank Albania

Georgios PAPANASTASIOU

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm, Alpha Bank Albania

Adrian CIVICI

Dekan Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

Maltin KORKUTI

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm, Credins Bank

Dritan MUSTAFA

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm, Tirana Bank

Eleonora OLLI

Kryetar i Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA)

Andi BALLTA

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm, Bank of Investments

Ervin METE

Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

Spiro BRUMBULLI

Sekretar i Përgjithshëm, Shoqata Shqiptare e Bankave



Paketa e Pagës

- Llogari Rrjedhëse
- Kartë Debiti
- SMS Banking
- Online Banking
- Depozitë Elastike

Nga mbyllja në hapje: rruga drejt krijimit të besimit



Prof. Asoc. Dr. Elvin MEKA¹
Kryeredaktor

Shpërthimi i pandemisë COVID-19 e kapit gjithë botën thuajse në befasi, pavarësisht se lajmet shqetësuese nga Kina ishin në qarkullim që nga janari. Sigurisht, siguria shëndetësore mori rëndësi të dorës së parë e në këtë mënyrë, gati e gjithë Evropa, e natyrisht dhe Shqipëria, aplikuan mbylljen e vendit dhe ekonomisë. Fillimisht, kjo mbyllje sociale dhe ekonomike frenoi përhapjen masive të koronavirusit, duke zbutur kështu trysninë mbi sistemin shëndetësor, por shpejt urgjenca shëndetësore u ballafaqua me një tjetër urgjencë më komplekse: letargjinë ekonomike dhe rrezikun e kolapsit ekonomik. Pra, urgjenca shëndetësore dhe kriza, u zëvendësuan me urgjencën ekonomike.

Aspekti më goditës i urgjencës ekonomike është se ajo ka evoluar si një pandemi ekonomike shumë virulente, ku e gjithë ekonomia botërore u zhyt si një e tërë dhe brenda disa javësh në krizë, duke ndjekur kudo një rrugë

pabesueshmërisht të ngjashme, drejt humnerës ekonomike. Pas shumë javë përpjekjesh, ekonomia filloi të hapet ngadalë, por qëndrueshëm dhe në mënyrë befasuese ne u bëmë dëshmitarë të asaj që kishim në mendje: ekonomia po vuan shumë dhe rruga drejt normalitetit do të jetë e gjatë dhe e dhimbshme, pasi kosto ekonomia e krizës Covid-19 është e pashembullt, si në rrafsh global ashtu edhe në atë kombëtar. Qeveria shqiptare dhe Banka e Shqipërisë ndërmorën hapa shumë të shpejtë dhe seriozë, për të ndaluar kolapsin ekonomik dhe financiar, duke ndërmarrë masat e duhura, si: dy paketa financiare dhe skemën të garancisë sovraane, shtyrjen e pagesës së kësteve të huave për klientët e bankës, masat mbështetëse për likuiditetin, një politikë monetare lehtësuese, masa lehtësuese të administrimit të rrezikut për sistemin bankar, etj.

Fatmirësisht, sistemi bankar në Shqipëri, si kudo, u gjend më i përgatitur përballë pandemisë, për sa i përket kapitalizimit dhe likuiditetit, kështu që ato e përballuan me sukses valën e parë të pandemisë, të mbështetur edhe nga masat e duhura të qeverisë dhe BSH-së. Deri më sot, këto masa kanë parandaluar dëmet dhe shkatërrimin e ekonomisë në afatgjatë, si dhe kanë siguruar vijueshmërinë e veprimtarisë së sistemit financiar, por ato nuk e kanë hapur përfundimisht rrugën drejt rimëkëmbjes ekonomike, pasi kriza e koronavirusit tashmë i ka shkaktuar ekonomisë një dëm strukturor, e për më tepër, ekonomia dhe procesi i rimëkëmbjes së saj


aktualisht po ecin në territor të panjohur. Kjo është sfida më e madh, nga i gjithë kompleksi i sfidave, për politikë-bërësit, rregullatorët dhe institucionet financiare, përfshirë dhe bankat, pasi kriza e fundit financiare-ekonomike nuk vlen si mësim për të ardhmen.

Sidoqoftë, për të ardhmen, sektori bankar dhe industria financiare duhet të përshtaten ndaj sfidave të shumta, që nga rritja e borxhit të qeverisë, recesioni, ulja e të ardhurave dhe shpenzimeve, mungesa e besimit të biznesit dhe individëve për të sipërmarrë rrezik dhe investuar, së bashku me inkurajimin e shpenzimeve private dhe riorganizimin e pashmangshëm të punës dhe vendit të punës. Një gjë është e qartë: Asgjë nuk do të jetë më si më parë! Pra, qeveria, rregullatorët, akademia dhe liderët e biznesit duhet të krijojnë besim për të ardhmen, megjithëse ajo do të jetë një rrugë e përpjetë e me shumë pengesa; ata duhet të nxitojnë për të përshtatur dhe rimodeluar ekonominë, nëpërmjet zbatimit të modeleve dhe strukturave të reja të biznesit, përmirësimit të produktivitetit, zhvillimit të produkteve të reja, tërheqjes së talenteve, përdorimit masiv të teknologjisë, etj. Praktiki, të gjithë duhet të rikujtojmë dhe zbatojmë ato që Presidenti amerikan Abraham Lincoln tha dikur: **"Mënyra më e mirë për të parashikuar të ardhmen tuaj është ta krijoni atë!"**

¹Dekan i Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, Universiteti Europian i Tiranës, UET

Sfidat e sipërmarrjes dhe ndihma qeveritare, gjatë pandemisë Covid-19

Tani që do duhet të jetojmë në një normalitet të ri, duke pasur koronavirusin mes nesh, jemi përqendruar me të gjitha energjitë te procesi i rimëkëmbjes ekonomike, duke punuar me disa skenarë, e për të cilët jemi ende në analiza të thella.



Eduard SHALSI

Ministër Shteti për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

Ndërkohë që pandemia e gjeti edhe botën e zhvilluar krejtësisht të papërgatitur, dy beteja zhvilloheshin në të njëjtën kohë, duke u dakordësuar dhe pranuar botërisht që, me gjithë hezitimet dhe qëndrimet e pasigurta dhe të mjegullta të disa liderëve botërorë, beteja kryesore dhe më e rëndësishme që duhej fituar ishte ajo shëndetësore.

Kjo periudhë e vështirë dhe e paimagjinueshme bëri që të vihej në dyshim gjithçka dhe të ndryshonte brenda një kohe të shkurtër mënyra e perceptimit të jetës dhe botës. Ndërkohë që në frontin e betejës shëndetësore u bë përqendrimi më i madh i forcave, lufta me koronavirusin nuk mund të mos fillonte të ndikonte përditë e më tepër ekonominë. E ndërsa izolimi i njerëzve dhe kufizimi i lëvizjes se tyre ishin masa të

mira për betejën shëndetësore, për ekonominë dhe biznesin ishin masa asfiksuese, që po hapnin një periudhë mjaft të vështirë, e që pritet të vazhdojë.

Beteja mbetet globale ndaj dhe reagimi duhej global. Kjo ishte arsyeja se ne, ndërkohë që filluam marrjen e masave me shumë shpejtësi, ndiqnim me



Ndërkohë që sistemi bankar ndodhet përpara sfidash të jashtëzakonshme, duhet kuptuar se me mekanizmat dhe instrumentet tradicionale bankare do të ishte e pamundur të tejkalohen me sukses pasojat e COVID-19 dhe se duhen gjetur mënyra të reja, e duhen marrë masa të jashtëzakonshme, për të përballuar situatën e paprecedent.



shumë kujdes edhe eksperiencën e vendeve të tjera, duke përlogaritur në rrethana aspak të lehta dhe të paprecedent cilat do të ishin masat më efikase.

Jo pak sfiduese gjatë kësaj periudhe dy mujore ka qenë mbajtja e një sërë takimeve online me grupet e interesit, si dhe vizitat nëpër sipërmarrjet e lejuara, për të kuptuar më mirë problematikat e tyre, në mënyrë

që të përcaktonim prioritetet. E rëndësishme ishte pikë së pari të krijoheshin kushtet që bizneset që ofronin produkte ushqimore, prodhues apo importues, të kishin mundësi të zhvillonin veprimtarinë e tyre, si dhe të disiplinoheshin lëvizja, duke mos e ndërprerë zinxhirin e furnizimit të popullatës dhe tashmë mund të themi se bashkërisht me sipërmarrësit ja dolëm me sukses, në kushte tmerrësisht të vështira.

Menaxhimi i situatës u realizua në mënyrë efektive, duke marrë në konsideratë kërkesat dhe ankesat, që u paraqitën nga përfaqësues të dhomave të tregtisë dhe shoqatave në vend. Në varësi të sektorit ku bizneset operojnë, kërkesat kanë qenë të tipologjive të ndryshme, ku më kryesoret lidhen me lehtësirat tatimore (TVSH, tatim-fitim, sigurime shëndetësore dhe shoqërore, etj.), subvencionet dhe mbështetjet financiare (për punonjësit, shërbimet, ose për qiranë), lehtësira në procedurat administrative, problematika me qarkullimin për mallrat dhe punonjësit, si dhe shqetësime në lidhje me transportin ndërkombëtar dhe ndërqytetas. Lehtësia e komunikimit me këta të fundit, falë urave të bashkëpunimit të ngritura në vazhdimësi, mundësoi adresimin e problematikave kryesore të lidhura me këtë krizë të pazakontë.

Krahas rëndësisë që ka pasur analiza e nevojave të ndryshme të çdo biznesi, tejet i rëndësishëm ka qenë konceptimi dhe hartimi i

paketave të ndihmës ekonomike. Këto paketa erdhën si rezultat i një numri të madh konsultimesh, jo vetëm me bizneset, por edhe me ekspertë të fushës, duke u përpjekur të mbështesim sipërmarrjen, por veçanërisht shtresat më të prekura.

Paketa e parë e ndihmës financiare, e prezantuar më 19 mars 2020, përfshiu një sërë masash të cilat u ndërmorën për të përballuar pasojat dhe luftën me koronavirusin në të gjitha frontet. Kjo paketë përbëhej nga ri-skedulimi i tatim-fitimit për të gjithë bizneset me qarkullim deri në 14 milionë lekë, shtyrja e dorëzimit të bilancit kontabël, së bashku me anekset e tij deri në 31 korrik, garancia sovraane për bizneset, "paga e luftës" për punonjësit si dhe shtyrja e afatit të pagimit të kësteve të huas, si dhe shtyrja e afatit për pagesat e qirave. Paketa e parë u erdhi në ndihmë rreth 38,645 bizneseve dhe rreth 64,886 punonjësve. Në këtë paketë, qeveria miratoi dhe mundësoi hyrjen në fuqi të një plani financiar për përballimin e situatës, dedikuar shëndetësisë, shtresave në nevojë dhe të papunëve. Gjithashtu, një element i rëndësishëm i paketës së parë ishte garancia shtetërore e huas me bankat tregtare për pagat e punonjësve në biznese, veprimtaria e të cilëve është prekur nga COVID-19, me një vlerë 11 miliardë lekë, garanci për të cilën qeveria mori përsipër edhe pagesën e interesave.

Duke ndjekur zhvillimet e situatës në vend, nëpërmjet paketës së dytë vijoi mbështetja ndaj bizneseve dhe punonjësve, veçanërisht përmes subvencionimit të pagave të punonjësve. Gjithashtu, kjo paketë ofroi një garanci të dytë shtetërore, jo vetëm për pagat, por edhe për

kapitalin qarkullues të shoqërive, në vlerën prej 15 miliardë lekë. Në të njëjtën kohë, u mundësua shtyrja e afateve të pagesës së kësteve paraprake të tatim-fitimit për të gjitha sipërmarrjet, duke përfshirë sistemin bankar, telekomunikacionin, kompanitë publike, si dhe kompanitë e zinxhirit të furnizimit me mallra ushqimore. Për subjektet që operojnë në fushën e turizmit, fasonerisë, call-center dhe bizneset me qarkullim vjetor deri në 14 milionë lekë, u realizua shtyrja e pagesave të kësteve paraprake të tatim-fitimit.

Siç u theksua më sipër, një kërkesë shumë specifike nga sipërmarrja dhe me ndikim të drejtpërdrejtë në ekonominë shqiptare, ka qenë domosdoshmëria për likuiditet për të përballuar nevojat për pagat e punonjësve, si dhe për kapital qarkullues. Nëpërmjet një bashkëpunimi të suksesshëm dhe intensiv me sektorin bankar janë finalizuar dy instrumentet e garancisë sovraane. Të vetëdijshëm për rëndësinë e sektorit bankar, si një nga shtyllat kryesore të zhvillimit të një ekonomie të qëndrueshme, qeveria shqiptare në bashkëpunim të ngushtë me këtë sektor, adresoi kërkesën kryesore të sipërmarrjes, për sa i përket likuiditetit. Fleksibiliteti i sektorit bankar në këtë situatë pasqyroi maturinë e arritur gjatë këtyre viteve, duke dëshmuar nivel të njëjtë ecurie me vendet e rajonit, e më gjerë.

Sigurisht, përgjatë gjithë këtij rrugëtimi të mundimshëm dhe të pazakontë, kemi ecur krah biznesit duke punuar me disa skenarë për tejkalimin e situatës, por edhe duke shpresuar në një balancim të ekonomisë shqiptare, në një kohë sa më të afërt. Kemi përpara nesh një sfidë globale aspak të

lehtë. Me fokus të veçantë në kompleksitetin e pandemisë, faza e rimëkëmbjes dhe rikuperimit do të shoqërohet me masa të tjera, me qëllim minimizimin e dëmeve dhe rimëkëmbjen sa më të shpejtë të ekonomisë në vend.

Ndërkohë që, mendoj se edhe sistemi bankar ndodhet përpara sfidash të jashtëzakonshme dhe, ndërsa deri me sot kemi rakorduar me bankën qendrore dhe bankat tregtare, mbi mënyrën e menaxhimit të situatës, lidhur me problemin e mungesës së likuiditetit, duhet kuptuar se me mekanizmat dhe instrumentet tradicionale bankare do të ishte e pamundur të tejkalohen me sukses pasojat e COVID-19 dhe se duhen gjetur mënyra të reja, e duhen marrë masa të jashtëzakonshme, për të përballuar situatën e paprecedent.

Tani që do duhet të jetojmë në një normalitet të ri, duke pasur koronavirusin mes nesh, jemi përqendruar me të gjitha energjitë te procesi i rimëkëmbjes ekonomike, duke punuar me disa skenarë, e për të cilët jemi ende në analiza të thella. Nuk ka ende vendimmarrje konkrete, pasi dinamika dhe vlerësimi i pasojave vijon dhe rruga e rimëkëmbjes mbetet për t'u shtruar me kujdes dhe maturi.

Së fundi, dëshiroj të ftoj të gjithë aktorët dhe faktorët ekonomikë e financiarë, publik e privat, që të vazhdojnë komunikimin konstruktiv që kanë pasur me ne gjatë gjithë kësaj periudhe, pasi vetëm me anë të komunikimit të vazhdueshëm dhe përcjelljes së problematikave të tyre, ne mund t'ju qëndrojmë afër e t'i mbështesim në tejkalimin e kësaj situatë tejet të vështirë, të cilën jam i bindur që do ta kalojmë me sukses.

Politika monetare si instrument kontrolli monetar dhe stabilizimi ekonomik

Goditja e papritur nga pandemia kërkoi një reagim të shpejtë dhe të shënjestruar të Bankës së Shqipërisë, për të zbutur kostot e njëhershme të krizës, për të shmangur transformimin e saj nga goditje ekonomike në krizë financiare, si dhe për të krijuar premisa për një ri-ngritje sa më të shpejtë të ekonomisë.



Erald THEMELI

Drejtor, Departamenti i Politikave Monetare
BANKA E SHQIPËRISË¹

Pasojat negative që pandemia Covid-19 po shkakton në ekonomi, kanë sjellë në vëmendje përgjigjen e autoriteteve publike për minimizimin e kostove ekonomike dhe sociale të saj. Politika monetare, që së bashku me politikën fiskale dhe atë makroprudenciale, përbën një nga tri format kryesore të ndërhyrjes së shtetit në ekonomi, ka një rol parësor në këtë drejtim. Ky artikull synon të ofrojë një përshkrim të rolit dhe misionit të politikës monetare në Shqipëri, të qëndrimit dhe instrumenteve që ajo ka përdorur për administrimin e situatës, si dhe të perspektivës së afërt të saj.

Misioni, regjimi dhe kuadri operacional i politikës monetare të Bankës së Shqipërisë

Në përputhje me parimet më

të mira të bankingut qendror, politika monetare e Bankës së Shqipërisë ka një objektiv të qartë: arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve.

Në përmbushje të këtij objekti, Banka e Shqipërisë zbaton regjimin e shënjestrimit të inflacionit. Ky regjim nënkupton se vendimmarrja e politikës monetare: (i) orientohet nga e ardhmja, duke marrë parasysh kohëvonesat e mekanizimit të transmetimit të politikës monetare; dhe (ii) faktorizon të gjithë informacionin ekonomik të përshtatshëm mbi ecurinë aktuale dhe të ardhshme të çmimeve. Po ashtu, në Dokumentin e Politikës Monetare përcaktohet se Banka e Shqipërisë zbaton një regjim fleksibël të inflacionit të shënjestruar, çka do të thotë se – pa paragjykuar respektimin e objektivit të inflacionit – politika monetare synon dhe zbutjen e luhatjeve afatshkurtra të veprimtarisë ekonomike rreth prirjes së saj.

Paralelisht me shënjestrimin e inflacionit, Banka e Shqipërisë zbaton dhe një regjim të lirë të kursit të këmbimit: raporti i shkëmbimit të lekut kundrejt valutave përcaktohet lirisht në treg, në përputhje me dinamikën e kërkesës dhe ofertës për valutë. Kursi fleksibël i këmbimit mundëson zbatimin e një politike monetare të pavarur, të orientuar drejt ruajtjes së stabilitetit të çmimeve, si dhe i ofron ekonomisë

një stabilizator automatik ndaj goditjeve të brendshme, apo të huaja.

Në këndvështrimin operacional, zbatimi i politikës monetare bazohet mbi një kuadër modern instrumentesh, të cilat janë në harmoni me parimet e tregut të lirë. Kjo nënkupton se, Banka e Shqipërisë nuk vendos kufizime administrative mbi nivelin e normave të interesit, apo vëllimin e huas. Në të kundërt, ajo përdor instrumente që ndikojnë vëllimin dhe kostot e likuiditetit në sistemin bankar, si një pikënisje për të ndikuar kushtet monetare dhe financiare në ekonomi, vëllimin dhe kostot e huas, ecurinë e konsumit dhe të investimeve, si dhe – në analizë të fundit – nivelin e çmimeve në ekonomi.


Qëndrimi aktual i politikës monetare

Goditja e pandemisë e gjeti Bankën e Shqipërisë në një kurs stimulues të politikës monetare, të iniciuar prej kohësh. Ky qëndrim është diktuar nga nivelet e ulëta dhe nën objektiv të inflacionit, të cilat kanë pasqyruar: (i) pamjaftueshmërinë e kërkesës agregate për të vënë në përdorim të plotë kapacitetet prodhuese të vendit dhe (ii) inflacionin e ulët në partnerët tanë tregtarë.

Stimuli monetar është administruar kryesisht nëpërmjet instrumenteve konvencionale të politikës monetare. Banka e Shqipërisë ka ulur në mënyrë agresive normën bazë të interesit,

¹ Mendimet e shprehura në artikull janë të autorit dhe nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Grafiku 1. Instrumentet e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

duke e sjellë atë në nivelet më të ulëta historike (paneli A, grafiku 1), ka rritur vëllimin e likuiditetit që ajo injekton në sistem dhe ka zgatur afatin mesatar të këtij injektimi (paneli B, grafiku 1). Paralelisht me to, Banka e Shqipërisë ka përdorur dhe orientimin e tregut mbi të ardhmen e politikës monetare, i njohur dhe si forward guidance. Ky instrument, i cili bën pjesë në grupin e instrumenteve jo-

konvencionalë, rrit transparencën mbi të ardhmen e politikës monetare, duke mundësuar një kontroll më të mirë të lakores së normave të interesit.


Përdorimi i këtyre instrumenteve u transmetua në normat e interesit të tregut financiar (paneli A, grafiku 2), u pasqyrua në zgjerimin e bilancit të Bankës së Shqipërisë (paneli B, grafiku 2) dhe krijoi premisat për një rritje graduale të huas (paneli

C, grafiku 2).

Ulja e kostos së huas dhe rritja e vëllimit të saj kanë mbështetur rritjen e kërkesës agregate dhe të presioneve të brendshme inflacioniste. Vlerësimet tona empirike tregojnë stimuli ynë monetar ka pasur një efekt të ndjeshëm në rritjen ekonomike (paneli A, Grafiku 3) dhe në inflacion (paneli B, grafiku 3).

Goditja e papritur nga pandemia kërkoi një reagim të shpejtë dhe

Grafiku 2. Ecuria e normave të interesit dhe bilancit i Bankës së Shqipërisë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

të shënjestruar të Bankës së Shqipërisë, për të zbutur kostot e njëhershme të krizës, për të shmangur transformimin e saj nga goditje ekonomike në krizë financiare, si dhe për të krijuar premisa për një ri-ngritje sa më të shpejtë të ekonomisë.

Në fushën e politikës monetare masat e marra rritën më tej stimulimin monetar, duke synuar funksionimin normal të tregjeve financiare, uljen e kostos së shërbimit të borxhit, dhe nxitjen e kreditimit. Rritja e stimulit monetar u realizua nëpërmjet uljes së normës bazë të interesit në minimumin historik prej 0.5% dhe heqjes së kufijve sasiore të injektimit të likuiditetit në sistemin bankar. Këto masa plotësuan masat makroprudenciale, të ndërmarra në interes të nxitjes së ristrukturimit të huave dhe garantimit të shëndetit të sektorit bankar, si dhe masat fiskale të cilat synuan zbutjen e kostove sociale në shtresat më të prekura dhe përmirësimin e gjendjes së likuiditetit të biznesit.

Efektet e para të tyre janë shfaqur tashmë, në përmirësimin e treguesve të luhatshmërisë, likuiditetit dhe në lëvizjen relativisht të qetë të fondeve në

tregjet financiare. Veprimet e marra nga Banka e Shqipërisë evidentuan edhe një herë rolin e rëndësishëm që bankat qendrore luajnë për menaxhimin e krizave.

Perspektiva e afërt e politikës monetare

Kriza që po jetojmë është e paprecedent, si në aspektin e fortësisë dhe në atë të kompleksitetit. Në këto kohë të trazuara, hartimi dhe zbatimi i politikës monetare vijon të orientohet nga përmbushja e mandatit të saj për stabilitetin e çmimeve.


Deri më tani, stimuli monetar i injektuar nëpërmjet kalibrimit dhe ndërthurjes së kujdesshme të instrumenteve konvencionalë të politikës monetare, vlerësohet të jetë i mjaftueshëm për të mbështetur rikuperimin e ekonomisë dhe rritjen e inflacionit drejt objektivit. Ky skenar konsideron përfundimin e shpejtë të pandemisë dhe përcjelljen e qetë e të plotë të stimulit monetar në ekonomi. Megjithatë, ne jemi të qartë se pasiguria në zhvillimet ekonomike dhe monetare mbetet ende e lartë. Zgjatja në kohë e krizës, apo problemet e mundshme në mekanizmin e transmetimit të politikës monetare, do të kërkonin

dhe një lehtësim të mëtejshëm të qëndrimit të saj. Duke u nisur nga hapësira e ngushtë që mbetet për stimul konvencional, në formën e uljes së mëtejshme të normës bazë të interesit, Banka e Shqipërisë ka përgatitur plane kontigjencë, ku merret në konsideratë përdorimi i instrumenteve jo-konvencionale të politikës monetare, si për shembull programet e lehtësimit sasior.

Në çdo rast, aktivizimi i planeve të kontigjencës do të jetë i kushtëzuar nga materializimi i rreziqeve potenciale, ndërsa përdorimi i instrumenteve jo-konvencionale do të bëhet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, si dhe do të marrë parasysh stadin e zhvillimit të tregjeve financiare dhe një analizë të detajuar të kostove dhe përfitimeve.

Banka e Shqipërisë do të mbetet vigjilente për monitorimin e situatës dhe vlerësimin e efektivitetit të politikës saj monetare. Si një institucion i pavarur, i orientuar drejt përmbushjes së mandatit dhe me një përqasje të kujdesshme në menaxhimin e rrezikut, ajo është e gatshme dhe e përgatitur të reagojë ndaj sfidave të ardhshme.

Grafiku 3. Ndikimi i politikës monetare në PBB dhe inflacion.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Bankat në përpjekje për një ri-ngritje dhe rritje të fortë

Nëse rimëkëmbja do të jetë e fortë dhe e qëndrueshme, Evropa duhet të përfitojë nga forca e tregut evropian, integrimi i mëtejshëm brenda BE-së, si dhe të promovojë praktikën më të mira për të gjithë partnerët e saj tregtarë, si një mënyrë për të integruar një treg më të zgjeruar evropian.



Burçak INEL

Drejtoreshë për Financimin e Rritjes,
Federata Bankare Evropiane
EBF/FBE

Gjatë tre muajve të fundit, pandemia Covid-19 ka lënë gjurmë të thella në kontinentin Evropian. Kjo krizë e paparë shëndetësore preku miliona qytetarë dhe biznese, me një ndikim shkatërrues në jetën dhe veprimtarinë e tyre të përditshme. Ndërsa që disa vende evropiane zunë vendet e para në renditjen globale të pandemisë, asnjë vend nuk i shpëtoi asaj, ndërkohë që u vijua me mbylljen e kufijve dhe bllokimin e dhimbshëm të jetës publike dhe profesionale. Në sektorin e shërbimeve, pjesa dërrmuese e veprimtarisë vijoi në rrugë digjitale, por industrinë (si dhe disa shërbime të tjera) që mbështeten në praninë fizike u përballën dhunshëm me ulje të menjëhershme të kapaciteteve të prodhimit dhe të kërkesës.

Gjithashtu, kriza pati një ndikim të fuqishëm në vendet në zhvillim, siç janë ato të Evropës Lindore dhe Ballkanit.

Tani për tani, përparësia numër një duhet të jetë siguria e qytetarëve, e ndjekur nga minimizimi i dëmit ekonomik. Ndërkohë që kriza shëndetësore po vihet nën një kontroll më të madh dhe vendet dalëngadalë po fillojnë të rihapin përsëri, në shkallë të ndryshme, ekonomitë e tyre, vëmendja do të zhvendoset në fillimin e rimëkëmbjes në të gjithë Evropën. Ndërsa pasojat krijojnë një "normale të re", viti i ardhshëm kërkon leadership dhe bashkëpunim të fortë, për të zbutur krizën ekonomike dhe për të filluar një rimëkëmbje të fortë e të qëndrueshme në kontinentin tonë.

Përvojat nga e gjithë Evropa tregojnë vlerën e dialogut të shëndoshë dhe bashkëpunimit të ngushtë. Sektorët privat dhe publik, NVM-të, konsumatorët, bankat dhe aktorët e ndryshëm duhet të jenë përherë në një dialog të ngushtë mes tyre. Nisur nga ndikimi global, që BE ka në aspektin rregullator dhe në politikëbërje, anëtarësia në rrjetin e Federatës Evropiane Bankare (EBF) siguron një burim të rëndësishëm informacioni mbi masat e marra ose të koordinuara, në nivelin BE-je, si dhe për praktikën më të mira në të gjithë Evropën. EBF merr një rol të fortë udhëheqës, si në aspektin e menaxhimit të krizës,

ashtu edhe të rimëkëmbjes. Përveç 32 anëtarëve të saj, EBF mban lidhje të forta edhe me grupin e Anëtarëve të Asociuar të EBF-së, përfshirë këtu edhe Shoqatën Shqiptare të Bankave, AAB. Për më tepër, shumë nga bankat më të mëdha evropiane kanë një prani të konsiderueshme ekonomike në këtë rajon me rritje të rëndësishme.

Prioriteti i parë ka qenë administrimi i krizës. Shpërthimi i pandemisë ishte aq i papritur dhe masiv sa që, shumë biznese dhe sipërmarrës thjesht nuk mund të vijonin më veprimtarinë e tyre. Qeveritë dhe mbikëqyrësit në të gjithë Evropën, përfshirë dhe Shqipërinë, kanë ndërmarrë veprime vendimtare, për të zbutur ndikimin e mundshëm ekonomik të kësaj krize, në bashkëpunim me bankat, si ofrueset kryesore të shërbimeve financiare.

Bankat multilaterale të zhvillimit, përfshirë ato me një fokus të qartë evropian, të tilla si: Banka Evropiane e Investimeve (EIB) dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), kanë qenë partnerë të spikatur të sektorit të bankave vendase, si brenda ashtu dhe jashtë BE-së. Deri më tani, BERZH-i ka disbursuar më shumë se 1 miliard Euro, me një portofol aktual prej 756 milionë Euro, ku 51 milionë janë të projektuara për Institucionet Financiare (kryesisht për linjat e kreditit për agrobiznesin).

Autoritetet mbikëqyrëse

shqiptare kanë deklaruar angazhimin e tyre për të ruajtur shëndetin e sistemit bankar shqiptar, nëpërmjet një numri masash. Së fundi, Banka e Shqipërisë zgjati moratoriumin e pagesës së kësteve të kredive edhe me tre muaj të tjerë, duke u dhënë bankave më shumë kohë për të ristrukturuar portofolet e huave, gjatë këtij viti. Vende të tjera jo anëtare të BE-së, si: Serbia, Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia e Veriut dhe Azerbajxhani, kanë treguar qëndrime të ngjashme bashkëpunuese, duke aktivizuar zgjidhje të partneritetit publik – privat, për të parandaluar skenarin më të keq në ekonomi.

Gjatë krizës, bankat e përfaqësuara nga EBF kanë qenë në qendër të përpjekjeve për të mbajtur në minimum ndikimin e krizës. Marrëdhëniet e ngushta të bankave me klientët e tyre ofruan një bazament të fortë për strategjinë evropiane për sigurimin e vazhdimësinë së biznesit dhe për të minimizuar pasojat. Bankat kanë marrë masa për sigurinë e klientëve, punonjësve dhe për të mbajtur në ritëm ekonominë. Për më tepër, duke punuar në mënyrë konstruktive dhe që herët me rregullatorët e kujdesshëm, bankat rritën fleksibilitetin e tyre, për t'i dhënë hua ekonomisë nën stres. Për më tepër, vendimi për mosdhënien e shpërblimeve për drejtuesit e lartë dhe vendimi për të pezulluar shpërndarjen e dividendëve, kontribuuan së bashku në rritjen e fluksit të likuiditetit në ekonomi. Vetëm nga vendimi për mos-shpërndarje të dividendëve ka siguruar më shumë se 300 miliardë Euro hua në dispozicion për qytetarët dhe bizneset evropiane.

Qëllimi final i këtyre përpjekjeve ishte kanalizimi i

fondeve publike dhe sigurimi i linjave të reja të huas për të përmbushur nevojat për likuiditet dhe rritjen e kapitalit qarkullues. Ndërsa shifrat e fundit nga BQE-ja nuk na japin ende një pasqyrë të plotë të fazës akute të krizës, shifrat e paraprake, përfshirë të dhënat edhe nga vendet jo-anëtare të BE-së, tregojnë se skemat publike dhe private kanë funksionuar sipas parashikimeve dhe se bankat i kanë mbështetur ekonominë, në periudha të vështira. Sipas anketës më të fundit të BQE për huadhënien bankare, huaja për bizneset në Euro zonë u rrit me 6.6% në prill të vitit 2020, krahasuar me një vit më parë, ritmi më i lartë që nga kriza e fundit financiare, më shumë se dhjetë vjet më parë. Provizionet për huat u rritën në mars 2020 me rreth 120 miliardë Euro, niveli më i lartë mujor. BQE ka vlerësuar një kapacitet huazimi prej 1,500 miliardë Euro, si rezultat i masave të kombinuara.

Grupi i BEI-t do të sigurojë 1,1 miliardë Euro për të mbështetur rimëkëmbjen sociale dhe ekonomike të Ballkanit Perëndimor nga pandemia Covid-19. Kjo është pjesë e paketës së ndihmës financiare prej 3.3 miliardë Eurosh për rajonin, e njoftuar më 29 prill nga Komisioni Evropian dhe ndjek përpjekjet e Team Europe për të mbështetur Ballkanin Perëndimor.

Aksesi në financim, edhe pse kritik, nuk është i vetmi qëllim këtu. EBF mbështet plotësisht dy prioritetet e identifikuar nga Komisioni Evropian - transformimin digjital të ekonomisë dhe kalimin drejt një ekonomie të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe të shëndetshme. Tashmë, gjatë fazës së rimëkëmbjes, që po mbështetemi më shumë në

infrastrukturat digjitale dhe po ushtrojmë më pak trysni mbi mjedisin, mund të shohim më mirë vlerën e vërtetë të këtyre përparësive strategjike. Me qëllim që përshtaten dhe të lulëzojnë në botë përtej krizës, qeveritë, ndërmarrjet dhe financuesit evropiane do të duhet të investojnë në veprimtari që gjenerojnë vlera afatgjata për shoqërinë – qofshin ato shëndeti publik, ruajtja e punësimit, parandalimi i krizave, apo prioritetet mjedisore. Kjo nënkupton një mundësi për të krijuar sinergji më të forta midis financimit publik dhe privat.

Lidershipi i Evropës në të dy fushat është i rëndësishëm dhe EBF po bën pjesën e saj, me lidershipin e saj në mbështetje të digjitalizimit të NVM-ve dhe ndërmarrjeve të tjera, si dhe të financave të qëndrueshme. Bashkëpunimi i ngushtë i EBF me NVM-të është gjithashtu një tjetër rrugë e rëndësishme drejt rimëkëmbjes. Sot, më shumë se kurrë, bankat evropiane janë të gatshme të ndihmojnë bizneset dhe klientët të kapërcejnë pasojat e pandemisë.

Institucionet publike të Evropës, së bashku me partnerët globalë, të tillë si: FMN dhe Banka Botërore, do të luajnë rol kyç në arritjen e këtyre qëllimeve, gjatë viteve të ardhshme. Mbi të gjitha, ka ardhur koha që Bashkimi Evropian dhe palët e interesuara e partnerët e tij të tregojnë forcën e tyre. Nëse rimëkëmbja do të jetë e fortë dhe e qëndrueshme, Evropa duhet të përfitojë nga forca e tregut evropian, integrimi i mëtejshëm brenda BE-së, si dhe të promovojë praktikën më të mira për të gjithë partnerët e saj tregtarë, si një mënyrë për të integruar një treg më të zgjeruar evropian.

COVID 19 – HAPJA

Ekspierienca e fituar pas krizës financiare të 2008-ës e ka bërë sektorin bankar më të kujdesshëm, më të përgatitur dhe më të kompletuar, edhe pse situata që po kalojmë është e paprecedent dhe nuk ekziston ndonjë eksperiencë e ngjashme nga e kaluara, për të bërë më të lehtë kapërcimin e saj.



Dr. Spiro BRUMBULLI

Sekretar i Përgjithshëm
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE, AAB

Ndërkohë që mbyllja për shkak të koronavirusit u bë e mundur nëpërmjet zbatimit të masave të rrepta, duke vendosur kontrollin mbi rastet e infektuara dhe mbrojtur pjesën tjetër të popullsisë nga mos-infektimi, një rrezik tjetër u evidentua – situata ekonomike. Llogaritjet për recesion, për papunësi, kërcënime të mungesës së artikujve ushqimorë, çekuilibre buxhetore, pamundësi të mjeteve të jetesës, etj., u formëzuan si sfida në tavolinat e politikëbërësve. Në planin mikroekonomik, rënia e të ardhurave, pakësimi i likuiditetit dhe përkeqësimi i aftësisë pagueuse, do të testojnë qëndrueshmërinë financiare të bizneseve dhe familjarëve. Në planin makroekonomik, rritja e borxhit publik dhe privat do

të testojnë qëndrueshmërinë e ekuilibrave ekonomikë të vendit.

Nga institucionet ndërkombëtare është bërë e qartë që Shqipëria do të jetë nga vendet e rajonit që do të ketë recesionin më të thellë, nga -5% në -9%. Efektet më negative do të vijnë nga turizmi, rënia e dërgesave të emigrantëve, bashkëpunimi me vendet fqinje (të prekura edhe ato, si: Italia dhe Greqia), si dhe mbetet për t'u parë sjellja e investuesve të huaj të rinj.

Qeveria, në vazhdim të masave të marra gjatë muajit mars, ndërmoi vendime për dy paketa financiare për trajtimin e gjithë biznesit të vogël dhe të punonjësve që kishin humbur vendin e punës për shkak të COVID-19, nëpërmjet trajtimit me “pagën e luftës” për tre muaj dhe me një pagesë të një shume të vetme prej 40,000 lekë. Me Aktin Normativ Nr.18 u bënë ndryshime për afatet e parapagimit të kësteve të tatim-fitimit dhe tatimin mbi fitimin e thjeshtuar për kategori të caktuara të tatimpaguesve, ku bie në sy shtyrja e kësteve për gjatë vitit 2021, me përjashtim të bankave, telekomunikacionit, tregtimit të produkteve farmaceutike dhe tregtimit të produkteve ushqimore dhe fruta-perimeve që do të kryejnë pagesat normalisht. Me akte të tjera normative u vendos shtyrja e detyrimit të qirasë për dy muaj (prill – maj), si për individët, ashtu edhe për personat fizikë/juridikë me të ardhura deri në 14 milionë lekë. U bë efektive garancia e parë shtetërore, që njihet si

garancia për pagat, për një shumë prej 11 miliardë lekë për të gjitha ato shoqëri tregtare që u prekën nga COVID-19, për të marrë hua për pagat e punonjësve të larguar nga puna, ku interesi i huas do të paguhej nga Qeveria. Deri në 31 maj, numri i bizneseve të miratuar arriti mbi 400, për një shumë të miratuar mbi 5 miliardë lekë.

Me VKM nr.387, datë 13 maj, Këshilli i Ministrave miratoi garancinë shtetërore për financimin e nevojshëm për rimëkëmbjen e veprimtarisë tregtare. Një shumë prej 15 miliardë lekë është vënë si garanci për bankat tregtare, ku Qeveria garanton 60% të kryegjësë së huas. Kjo garanci do të jepet për çdo shoqëri tregtare të prekur nga vendimet kufizuese të Qeverisë në kuadër të COVID-19, për kapital qarkullues apo për investime, me maturim maksimumi 5 vjet.

Banka e Shqipërisë, si autoritet i politikës monetare, ka marrë një sërë masash për të përballuar pandeminë nga koronavirusi, si:

- ulja e normës bazë të interesit në 0.5%, historikisht nivelin më i ulët;
- injektim i likuiditetit. U ndryshua forma e ankandit për injektimin javor të likuiditetit nga ankand me shumë të kufizuar në ankand me çmim të fiksuar. Bankat tregtare mund të marrin likuiditet pa kufi nga Banka e Shqipërisë, me koston e normës bazë të përcaktuar prej saj, e cila për momentin është në nivelin 0.5%.
- pezullimi i shpërndarjes së

PROJEKTONI KURSIMET TUAJA

FLEXSAVE



ProCredit Bank

fitimit nga bankat (fitimin e mbartur nga periudhat e mëparshme, fitimin e realizuar në vitin 2019, si dhe fitimin që do të realizohet përgjatë gjashtëmujorit të parë 2020), deri në fund të muajit qershor 2020.

- trajtimi i lehtësuar (ponderim me 0%) i ekspozimeve të bankave ndaj titujve të borxhit të qeverisë shqiptare në monedhë të huaj, për ato tituj që do të emetohen gjatë vitit 2020, i vlefshëm deri në maturimin e këtyre titujve.

- heqja përkohësisht e komisioneve të aplikuara nga bankat për transfertat e kreditit në lekë, në formë jo letër nga klientët e tyre, si dhe të tarifave për pjesëmarrësit në sistemet e pagesave AIPS dhe AECH të operuara nga Banka e Shqipërisë, duke filluar nga data 10 prill 2020.

Edhe pse tremujori i parë i vitit tregoi një prirje të qëndrueshme të rritjes së sektorit bankar për huadhënien, për depozitat, për fitimin, për mjaftueshmërinë e kapitalit dhe për mos-rritjen e NPL-së, mbyllja e detyruar për bizneset dhe individët, për shkak të pandemisë së COVID-19 dhe masat lehtësuese për huamarrësit, goditja që ka pësuar sektori real, sigurisht nuk do të kalojë pa lënë gjurmë, as në tregun financiar dhe as në treguesit e veprimtarisë të sektorit bankar. Eksperienca e fituar pas krizës financiare të 2008-ës e ka bërë sektorin bankar më të kujdesshëm, më të përgatitur dhe më të kompletuar, edhe pse situata që po kalojmë është e paprecedent dhe nuk ekziston ndonjë eksperiencë e ngjashme nga e kaluara, për të bërë më të lehtë kapërcimin e saj. Bota ndodhet para një sfide që të gjithë së bashku po ecim me hapa të kujdesshëm dhe duke përfitur nga çdo eksperiencë pozitive kudo që vërtetohet. Nuk ekziston një plan rikuperimi i parapërgatitur

për këtë lloj situatë dhe ky është mësimi i parë nga mbyllja dhe ajo që po përballemi tani në hapje.

Edhe pse afati për shtyrjen e tre kësteve të huave përfundoi në fund të muajit maj (numri i huamarrësve përfitues arriti mbi 23 mijë, për një shumë të miratuar prej 244 miliardë lekë), rimëkëmbja e bizneseve dhe familjarëve është e pamundur të ndodhë gjatë muajit qershor. Industria bankare kërkoj shtyrjen për një periudhë më të gjatë të mospagimit të kësteve të huave dhe për mosngarkim me provizione të bankave, për shkak të



Pavarësisht të qenit vend i vogël, porosia online dhe të shërbyerit online do të jenë pjesë e mënyrës sonë të jetesës. Ky është një moment që duhet shfrytëzuar më mirë në dobi të së ardhmes. Investimet në teknologji duhen të synojnë objektiva tashmë të qarta dhe të domosdoshme.



ristrukturimeve, apo mos-pagimit të kësteve gjatë kësaj periudhe shtyrje – propozime këto që u miratuan nga Banka e Shqipërisë në fund të muajit maj. Efekti i kësaj mase është drejtpërdrejt shtim i likuiditetit në duart e familjarëve dhe bizneseve huamarrëse. Vetëm nga shtyrja e kësteve me tre muaj (mars- maj) likuiditeti i shtuar në duart e huamarrësve llogaritet mbi 9 miliardë lekë.

Investimet e kryera nga industria bankare për ofrimin e shërbimeve online, familjarizimi i shumë klientëve për veprime nga kompjuteri, ose smartfoni, ndihmuan jo vetëm që shumë

shërbime të mos mungonin, por edhe të zgjerohej gama e shërbimeve nëpërmjet platformave të tjera elektronike: si e-albania. Një gjë pozitive nga kjo mbyllje mund të konsiderohet familjarizimi i klientëve me shërbimet online, në mënyrë elektronike, pa pasur nevojë për praninë fizike në pikat e shitjes, apo të shërbimit. Nga ana tjetër, një mbyllje e tillë na sugjeron që diapazoni i shtrirjes së shërbimeve elektronike duhet zgjeruar. Mundësia e kryerjes së pagesave online për çdo shërbim publik, por edhe ato e-commerce duhet të përshpejtohen dhe konsolidohen. Pavarësisht të qenit vend i vogël, porosia online dhe të shërbyerit online do të jenë pjesë e mënyrës sonë të jetesës. Ky është një moment që duhet shfrytëzuar më mirë në dobi të së ardhmes. Investimet në teknologji duhen të synojnë objektiva tashmë të qarta dhe të domosdoshme.

Ajo që mungon në hapjen e ekonomisë pas mbylljes për shkak të COVID-19 është eksperienca për situatën e re për huadhënie. Situata pas mbylljes tremujore të shumë bizneseve nuk i ngjan më asaj të muajit shkurt. Çdo analizë bazuar në të shkuarën bëhet e pavlefshme. Analiza duhet të orientohet nga e ardhmja dhe sa më shumë të shkojmë në të ardhmen, aq më të pasigurta janë parashikimet. Pra, duhet zhvilluar një model i ri i analizës, pasi rreziqe të reja duken në horizont. Si do të akomodohen ato në analizat përkatëse, si do të rritet shkalla e parashikueshmërisë, sa të qarta dhe të prera janë politikat makroekonomike të zhvillimit afatmesëm, si do të jetë lidhja me ekonominë e tjera – të gjitha këto janë pjesë e sfidës për t'u përballur. Hapja kërkon përgatitje të re për normalitet drejt një mënyre dhe jetese të re!

Bankat përballë COVID-19

BANKIERI:

1. Cila është ecuria e rasteve të kërkuara dhe miratuara (çfarë segmenti – biznes apo retail, çfarë produkti – personale, strehim, kapital qarkullues, për investime, etj.)
2. Çfarë problemesh kanë lindur gjatë ristrukturimit të huave?
3. A mendoni se do të ketë ndikim në rezultatin financiar vjetor të bankës shtyrja e kësteve?
4. A ka pasur kërkesa të reja për hua gjatë kësaj periudhe? Të çfarë natyre?
5. Duke qenë se është hera e parë që në Shqipëri aplikohet një garanci shtetërore për mbështetjen e biznesit, si do e vlerësonit ju këtë masë?
6. Çfarë do të rekomandonit për një përdorim edhe më të mirë të një instrumenti të tillë? A mund të përdoret edhe në të ardhmen, pas kalimit të “mbylljes”?



ALPHA BANK ALBANIA

Nikolaos Lamprakakis

Anëtar i Bordit Ekzekutiv për Biznesin me Shumicë

1 Lidhur me shtyrjen e kësteve të huave mund të pohoj se kërkesat kanë ardhur si nga huamarrës individë, ashtu edhe nga biznese. Deri në fund të muajit Maj 2020, Alpha Bank Albania ka marrë 816 kërkesa nga klientë individë, kryesisht lidhur me huat konsumatore dhe 93 kërkesa nga biznesi i vogël dhe i mesëm, si dhe nga korporatat. Nga këto kërkesa kanë përfituar lehtësi për

pagesat deri më tani 80% e klientëve individë dhe 91% e klientëve biznes, ndërkohë që kemi ende raste që po trajtohen.

2 Procesi ka pasur problematika të lidhura këto me klientin, i cili duhet të vërtetonte se ai është prekur nga masat anti-COVID-19, për të përfituar nga skema e shtyrjes së kësteve të huave, sipas moratoriumit dhe me kuadrin ligjor e rregullator të vendit. Gjithsesi, procesi ka ecur normalisht dhe me besim, si nga banka, ashtu edhe nga huamarrësit. Gjithashtu, jam i bindur se edhe për periudhën e mbetur, deri në fund të gushtit 2020, procesi do të sjellë përfitime për të gjithë palët.

3 Është ende herët të flitet për pasojat afatgjata. Për individët dhe huamarrësit shtyrja e kësteve u mundësoi atyre frymëmarrjen e duhur ekonomike. Shtyrja e kësteve të huas e bën sistemin bankar kontribuesin më të madh në përballimin e krizës, duke ushqyer ekonominë dhe familjet me likuiditet tepër të domosdoshëm në këtë periudhë. Natyrisht, kjo do të sjellë pasoja në treguesit e ecurisë dhe pozicionet financiare të bankave, por

duhet theksuar se kriza, sikurse do të ketë pasoja, në vijim do të sjellë edhe përfitime për të gjithë aktorët ekonomikë, përfshirë dhe bankat.

4 Huamarrësit individë kanë vazhduar të paraqesin kërkesa për hua të reja, edhe pse në një numër më të ulët, krahasuar me muajt e mëparshëm. Bizneset kanë qenë më të ngurtë, për shkak të pasigurisë që kanë për zgjatjen e krizës dhe për periudhën pas krize. Për huamarrësit biznes u vu re një përdorim i madh i kufijve ekzistues të kredisë (overdraft-eve), si edhe i mbetjeve të shumave në llogaritë rrjedhëse pranë bankave. Po ashtu, këta huamarrës shfaqën interes edhe për të përfituar nga skemat e huadhënies me garanci shtetërore, me qëllim pagimin e pagave për punonjësit dhe për nevoja për kapital qarkullues e investime, me afat vetëshlyerje deri në 5 vjet.

5 Skema e parë e huadhënies për pagat e punonjësve me garanci shtetërore është një skemë shumë e mirë, që po aplikohet edhe në disa vende të tjera. Tashmë kjo skemë, me përmirësimin e fundit që iu bënë, ku interesat subvencionohen 100 %

nga shteti, është tepër tërheqëse dhe shumë e dobishme për bizneset, që i kushtojnë rëndësi marrëdhënies afatgjatë me punonjësit dhe mbajtjes në punë të punonjësve të talentuar.

Skema e dytë e huadhënies, ku shteti garanton 60% të huas, për kapital qarkullues dhe investime (ku huaja nuk mund të jetë më shumë se 300 milionë lekë), për ato shoqëri të cilat janë prekur nga kriza dhe masat anti-krizë, mendoj që mirëpritet nga biznesi dhe, sipas pikëpamjes sime, kërkesa si nga klientët ekzistues, ashtu edhe ata të rinj, do të jetë e konsiderueshme, duke qenë se do të ushqejë këto biznese me likuiditet të ri për një periudhë relativisht të gjatë (deri 5 vjet).

6 Mendoj se qeveria arriti t'i paraqesë biznesit të dy instrumentet në një interval të shkurtër kohor, duke shmangur çdo efekt negativ nga mos-shpallja e tyre në të njëjtën kohë. Kjo bëri që stepja e biznesit për të aplikuar, sipas skemës së parë, të ishte e shkurtër në kohë. Njëkohësisht mendoj se kriteret për t'u kualifikuar, sipas skemës së parë, duhet të ishin më të mirëpërcaktuara. Skemat e huadhënies me garanci shtetërore janë të njohura në gjithë botën, por në shumë vende këto janë zëvendësuar me subvencione të drejtpërdrejta nga shteti, ose me programe zhvillimi me ndikim të ulët e shumë të ulët të qeverive qendrore apo vendore.



BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE

Gresa Panajoti

Këshilltare e Drejtorit të

Përgjithshëm për Çështjet e Riskut

1&2 Pas shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, Banka Amerikane e Investimeve duke zbatuar udhëzimet rregullatore të dala për këtë situatë, ka vepruar me shpejtësi dhe ka trajtuar kujdes të veçantë kërkesat e klientëve të prekur nga pandemia. Kërkesat që janë trajtuar kanë ardhur nga të gjitha segmentet e portofolit të bankës: individë dhe biznese.

4 Paralelisht me menaxhimin e kërkesave për shtyrjen e kësteve të huave, ABI Bank ka mirëpritur dhe ka trajtuar normalisht edhe kërkesa për hua të reja, si nga individë, ashtu edhe nga biznesi. Kërkesat kanë qenë të natyrave të ndryshme, por do të veçoja sidomos ato me natyrë investimi.

5 Menjëherë pas njoftimit për mundësinë për financim të fondit të pagave nëpërmjet garancisë sovrane, ABI Bank mori të gjitha masat për t'u përgjigjur kërkesave të klientëve. Për këtë qëllim, u ngrit një ekip i dedikuar me analistë financiarë, specialistë të rrezikut dhe juristë të bankës, të cilët trajtuan me përparësi kërkesat e ardhura për "Kredi pagash mbështetur me garanci sovranë". Kërkesat e trajtuara gjatë

kësaj kohe kanë ardhur si nga klientë huaje ekzistuese, ashtu edhe nga klientë vetëm operacional, të cilët kishin kanalizuar nëpërmjet bankës pagesat e pagave të punonjësve të tyre, deri në shkurt 2020. Kërkesat kanë qenë nga sektorë të ndryshëm të ekonomisë të prekur nga situata aktuale dhe vendimet e Qeverisë, si dhe klientë të madhësive të ndryshme (biznesi i vogël, i mesëm apo dhe i madh).

Në vijim, ABI Bank po përgatitet për t'u përfshirë në skemën e Garancisë së dytë Sovrane për hua, me qëllim rimëkëmbjen e bizneseve të prekura drejtpërdrejt apo tërthorazi nga situata e krijuar nga Covid-19. Ashtu si eksperiencia me Garancinë Sovrane për hua pagash, pritshmëria jonë është që klientët dhe bankat të tregojnë një bashkëpunim dhe mirëkuptim në përgatitjen dhe dorëzimin e informacionit të kërkuar, sipas standardeve të kredidhënies së bankës.



CREDINS BANK

Florian Popi

Drejtor i Departamentit të Rrezikut të Kredisë së Biznesit të Madh

1 Për të gjithë huamarrësit në vështirësi financiare, pas kërkesës dhe aprovimit në bazë të kushteve të secilit huamarrës dhe brenda afateve

të dakordësuar mes palëve, është pezulluar pagesa e kësteve të huas, apo të interesave për linjat e kredive/ overdraft-eve, për periudhën 13 mars – 31 maj 2020. Kërkesat kanë qenë në numër të lartë, ku mund të përmendim për segmentin e Individëve me rreth 1,050 huamarrës, nga këto të aprovuar në masën 81%, e në vlerë monetare janë 84.1% të aprovuar. Ndërkohë, për segmentin Biznes janë 1,212 huamarrës, nga këto të aprovuar në masën 85.89% dhe në vlerë monetare janë 91.77% të aprovuar. Produktet për shtyrje të kësteve kryesisht kanë qenë huat me plan pagesë me këste mujore për segmentin Biznes dhe huat hipotekare në segmentin e Individëve, por edhe produktet për kapital qarkullues, siç janë overdraft-et dhe linjat e huave për segmentin Biznes, për të cilën kanë pagesat tremujore në periudhën e referimit.

2 Disa nga problematikat për shtyrjen e kësteve janë paqartësia e ecurisë gjatë vitit 2020 dhe kostot financiare, si për segmentin e Individëve, ashtu edhe për segmentin Biznes. Përveç kostove financiare, që Banka Credins mundohet të minimizojë në maksimum për huamarrësit, so pasojë e shtyrjes së kësteve, një tjetër problematikë që vihet re është pasiguria e lartë në parashikimin e ecurisë financiare, veçanërisht të bizneseve, në periudhën afatshkurtër.

3&4 Banka Credins është përsh-tatur, duke ofruar produkte të reja të dizajnuara për këtë situatë dhe në strategjinë e saj do të vijojë me financimet për kapital qarkullues dhe për investime, për të gjithë segmentet e huamarrësve. Gjithashtu, kjo strategji, e kombinuar me lehtësirat që do të derivojnë nga pezullimi i përkohshëm i rregulloreve mbi administrimin e rrezikut nga Banka e Shqipërisë, si

edhe nga ofrimi i produkteve bankare me kolateral Garancinë Sovrane, në tërësi parashikojmë ndikim pozitiv në pasqyrat financiare të bankës për vitin ushtrimor 2020.

5&6 Produktet e huas të mbuluar me Garanci Sovrane shihen pozitivisht nga bizneset dhe nga ana e bankës rekomandohet që të përdoren në vazhdimësi, pas kalimit të bllokimit nga pandemia Covid-19. Këto produkte do të ishin shumë të favorshme nëse do të krijoheshin sektorë strategjikë të ekonomisë shqiptare (si: turizmi, industria e përpunimit, bujqësia, etj.), por edhe për kategori biznesesh që kanë dhënë, ose parashikohet të japin ndikim pozitiv, si në ekonominë e vendit, ashtu edhe në mjedis dhe kulturën socio-ekonomike të vendit.

INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA




Ervin Xhomo

Drejtues i Divizionit të Korporatave & SME

Moratoriumi i huave ishte një masë e detyrueshme dhe e paevitueshme, që u ndërмор me shpejtësi nga qeveria shqiptare, në dakordësi me Bankën e Shqipërisë, e u mirëprit nga sipërmarrja shqiptare dhe e

huaj. Deri më sot, 50% e klientelës Korporatë & NMV ka aplikuar dhe përfituar nga moratoriumi, duke fituar kohën e nevojshme për të analizuar situatën dhe efektet në ndërmarrjet respektive dhe për të negociuar me kujdes me bankën rifillimin e shlyerjes së huave dhe ri-përcaktimin e planit të pagesave. Kërkesa për hua momentalisht është e përqendruar në plotësimin e nevojave për pagesat e pagave të punonjësve ose kapital qarkullues, të cilat janë duke u plotësuar si dhe duke u mbështetur në paketat e zbatuara me mbështetje të garancive qeveritare, ashtu edhe me një fond specifik prej 50 milionë Euro, të aprovuar në mars nga Bordi Drejtues i Intesa Sanpaolo Bank Albania, me kushte mjaft të favorshme. Në situatën aktuale, siç pritet, evidentohet një zvogëlim i kërkesës për hua për investime të reja, pasi ndërmarrjet në përgjithësi i shtyjnë planet e investimeve jo të domosdoshme.

Vlerësoj eksperiencën pozitive të krijuar nga aplikimi i paketës së pagave me garanci sovrane dhe bashkëpunimin e sektorit bankar me Ministrinë e Financave & Ekonomisë; kjo bëri të mundur zbatimin gradual të marrëveshjeve dhe rritjen e fluksit të aplikimeve dhe disbursimeve të huave. Parashikojmë që fondi i shpërndarë për Intesa Sanpaolo Bank Albania të përdoret brenda muajit qershor. Ndërkohë, kanë filluar aplikimet lidhur me paketën e dytë.





Klodiana KEÇI "PIQANI"

Drejtoare e Divizionit të Shërbimeve Bankare për Individë dhe Biznese të Vogla

1 Banka ofroi mbështetjen e saj dhe mundësinë për të aplikuar për moratorium për të gjithë klientët e saj. Më shumë se 99% e të gjithë kërkesave për moratorium të individëve dhe klientëve të biznesit u miratuan dhe rezervuan në sistem, brenda një kohe shumë të shkurtër. Për sa i përket numrit, huat hipotekare mbizotërojnë në numrin e përgjithshëm të huave për individë, të aprovuar për moratorium, ndërkohë që për sa i përket vëllimit huat hipotekare llogariten më shumë se 85% të vëllimit për kreditë e aprovuara për moratorium. Sa i përket ekspozimit të biznesit, moratoriumi është shtrirë në mënyrë të barabartë, si për investimet, ashtu edhe për financimin e kapitalit qarkullues, që përfaqëson thuhajse 60% të portofolit të përgjithshëm.

2 Duke qenë të vetëdijshëm për ashpërsinë e një situatë të tillë, pamundësinë për të parashikuar afatet kur do të mbaronte kriza pandemike dhe pasojat e saj të dukshme në kapacitetin e ripagimit si të familjeve ashtu edhe të kompanive, që në fillim Intesa Sanpaolo Bank Albania mori vendimin për zgjatjen

e moratoriumit. I gjithë ky proces është trajtuar dhe po trajtohet pavarësisht nga të gjitha masat e tjera të kufizimeve, që duhej të zbatonim në drejtim të sigurisë shëndetësore të stafit dhe klientëve tanë dhe respektimin e protokolleve të vendosura nga rregullatorët dhe autoritetet përkatëse.

3 Intesa Sanpaolo Bank Albania ka një situatë financiare solide dhe të gjitha raportet demonstrojnë se kemi aftësi të plotë në kryerjen e rolit tonë dhe të japim kontributin tonë për ekonominë shqiptare, për të kapërcyer situatën e tillë.

4 Për shkak të situatës së pandemisë, sjellja e konsumatorit ndikohet dhe patjetër që do të ndryshojë. Konsumatorët do të kenë një qasje më të kujdesshme ndaj nevojave të tyre dhe buxhetit të shpenzimeve, si dhe do të jenë më të orientuar drejt kursimeve, në mënyrë që të rimarrin atë që kanë humbur gjatë kësaj periudhe dramatike, si dhe të jenë të përgatitur të përballojnë ditë të vështira. Mbetet normale dhe e pritshme që, nga sot kërkesa për hua të reja, posaçërisht për individë dhe hua konsumatore, të jenë në nivelin më të ulët historik që kemi pasur ndonjëherë, pasi shumë individë kanë pësuar humbje, ose ulje të të ardhurave dhe, në një farë mënyre, niveli i pasigurisë është rritur mes tyre.

5 Deri më tani, numri i përgjithshëm i biznesit të vogël që ka aplikuar është është rreth 38, me një shumë totale 1.2 milionë Euro. Banka ka zbatuar një qasje të ekuilibruar në këtë proces, duke stimuluar dhe aprovuar të gjitha ato shoqëri që mund të mbështeten nga financimi dhe të shmangim mbingarkesat e shoqërive të tjera, që mund të dëmtohen më shumë nga instrumenti se sa të përfitojnë prej tij.

6 Në mënyrë që skema të tilla të luajnë plotësisht dhe në mënyrë efektive rolin e tyre, ato duhet të drejtohen drejt individëve dhe shoqëritë pa ndonjë kosto, në mënyrë që shoqëritë private të mos hezitojnë t'i përdorin dhe të kenë frikë se si dhe nëse do të kenë aftësinë për të shlyer. Perimetri i shoqërive që kanë të drejtë të marrin fondet duhet të përcaktohet, duke marrë parasysh të gjithë zinxhirin e furnizimit dhe rrethin ekonomik, në mënyrë që të lehtësojnë dhe akomodojnë të gjithë sektorët e ekonomisë.



OTP BANK ALBANIA

1 Zbatimi i Moratoriumit është bërë menjëherë, duke ndihmuar të gjithë klientët me ndalimin e pagesave të kësteve të huas, por duke qenë se procesi është kompleks dhe kërkon shumë ndërhyrje, edhe manuale, do kohën e vet, që të quhet i përfunduar. Për ne është shumë e rëndësishme që klientët të jenë të shërbyer, të mos vuajnë asnjë efekt nga procesi i punës së bankës dhe të jenë të mirë-informuar, hap pas hapi.

2 Kërkesat e klientëve janë të ndryshme, siç janë edhe situatat e tyre financiare, mundësitë e tyre për të planifikuar dhe artikulimi i saktë i nevojës që ata faktikisht kanë. Shtyrja e kësteve është bërë duke konsultuar secilin subjekt dhe individ dhe jo një zgjidhje automatike gjithëpërfshirëse, identike për të gjithë. Kjo ka marrë shumë energji



**Raiffeisen
BANK**

SKANO
DHE PAGUAJ

**PAGESA TË SHPEJTA
NGA CELULARI**

Skano dhe paguaj me Raiffeisen ON

dhe kohë njerëzore për t'u realizuar, por kjo është edhe ndër parimet e punës së Bankës OTP Albania - eksperiencia unike dhe individuale për klientët - për të ofruar zgjidhjet e personalizuara dhe më të përshtatshme për klientin.

3 Moratoriumi ka dhe do ketë patjetër ndikim financiar, si për shumë industri të tjera. Sidoqoftë, menaxhimi dhe i gjithë stafi i Bankës OTP Albania është angazhuar për t'iu gjendur në krah klientëve, biznese dhe individë, që të kalohet me sa më pak pasoja kjo periudhë e pandemisë. Mes dilemës: "kosto kundrejt cilësisë", ne kemi zgjedhur cilësinë në favor të shërbimit ndaj klientëve, por dhe sigurisë së klientëve dhe stafit.


Në ngjarje si kjo që po kalojmë, që hyn në kategorinë e krizave, aftësia është të dish të administrosh të gjithë veprimtaritë, ku themelore mbetet jeta dhe shëndeti i njerëzve pa asnjë dallim: punonjës, klientë, miq dhe partnerë. Menjëherë pas kësaj, impenjimi është për të administruar edhe efektet që kriza shkakton dhe sa më të pakta të jenë efektet negative për të gjithë, aq më e suksesshme konsiderohet fitorja. Mirëqenia e punonjësve dhe klientëve është drejtpërdrejt e lidhur me mirëqenien e bankës sonë. Besojmë që çdo kosto shtesë, fitim i munguar, apo përpjekje njerëzore është një investim që i vlen vendit dhe do të kthehet pozitivisht në të ardhmen, për bankën dhe çdo individ të shoqërisë.

4 Huadhënia nuk është me ajo që ishte para muajit mars dhe kjo është e pritshme. Huadhënia vijon dhe gjatë ditëve të fundit kërkesat janë shtuar ndjeshëm. Ndërkohë, mund të themi se garancia sovraane ka qenë një nga tipologjitë e kreditimit e nxitur edhe nga oferta dhe lëvizja e qeverisë në ndihmë të biznesit, por edhe bankave

në formë jo të drejtpërdrejt.

5 Garancia Sovraane për sigurimin e huave për pagesat e pagave, u nënshkrua në 10 prill 2020. Janë rreth 36 subjekte që kanë aplikuar, me shumë 587 milionë lekë dhe 4,500 pagamarrës të segmenteve të ndryshme, nga korporatat deri te bizneset shumë të vogla. Aktualisht, jemi në fazën e zbatimit të shpejtë të saj. Nga eksperiencat tona, koordinimi i shumë aktorëve është i vështirë, por të gjitha bankat dhe Ministrinë kishin dëshirën për të bashkëpunuar dhe vërejmë me kënaqësi që u gjet shpejt mirëkuptimi. Kjo është shumë e rëndësishme të theksohet, pasi eficaenca e rakordimit në rastin e shumë aktorëve, ndikon drejtpërdrejt në ecurinë e biznesit dhe në injektimin eficient të likuiditetit të kërkuar. Në situata krizash koha është faktor përcaktues për daljen në dritë ose jo, si dhe përcakton dhe sasinë e efektit të shkaktuar. Së bashku ia dolëm të veprojmë me eficaencë në kohë të admirueshme. Ne mendojmë se garancia sovraane është një mekanizëm i nevojshëm, në funksion të mos degradimit ekonomik dhe një manovër financiare konkrete.

6 Ne e rekomandojmë fuqimisht përsëritjen e një eksperience të tillë, por gjithmonë për situata dhe sektorë të veçantë, sepse besojmë që tregu dhe konkurrenca janë instrumentet më të mirë dhe tregu bankar në Shqipëri është vërtet konkurrues dhe cilësor.



RAIFFEISEN BANK SHQIPËRI Evis ÇELIKU

Drejtoresh e Divizionit të Riskut Retail

1 Kërkesat për shtyrje të kësteve kanë ardhur si nga klientë në sektorin e biznesit, ashtu edhe nga individët. Fluksi më i madh i tyre ka qenë përgjatë dy muajve të parë, duke ardhur në rënie. Ne si bankë kemi qenë të angazhuar në mbështetjen e plotë të të gjithë klientëve, sikurse dhe një trajtim më specifik për të gjithë ata klientë që kanë shfaqur vështirësi ri-pagimi edhe përpara pandemisë, duke trajtuar me rigorozitet dhe shpejtësi maksimale secilin rast të paraqitur. Nisur nga karakteristikat e portofolit të huas në segmentin retail, pjesa dërrmuese e aplikimeve (rreth 98% e totalit) kanë qenë nga individët. Kur vijmë te produktet e huas, kemi një baras ndarje vëllimesh mes atyre të siguruar dhe atyre të pasiguruar, ndërkohë që, në numër aplikimesh, prirja shkon më shumë drejt huave të pasiguruar, ku huat personale zënë 75% të totalit.

2 Procesi i shtyrjes së kësteve është një proces që normalisht kërkon angazhim individual mes bankës dhe klientit. Numri i lartë i kërkesave të marra gjatë kësaj periudhe prej moratoriumit, përgjegjësia e bankës për kthim përgjigje te klientët brenda

3 ditësh nga data e aplikimit, si dhe pamundësia për të lëvizur gjatë kësaj periudhe, për shkak të kufizimeve nga pandemia, kërkonte angazhim maksimal nga stafi. Për t'ju përgjigjur menjëherë nevojave të klientëve dhe për të lehtësuar gjendjen e tyre, ishim banka e parë që aktivizuam për aplikime platformat digjitale, aplikacionin Raiffeisen ON dhe faqen e internetit të bankës, duke mbajtur fokusin kryesor mbi shëndetin e stafit dhe klientëve tanë, si dhe për të rritur eficiencën, në përgjigje të kësaj situatë të krijuar.

Gjatë kësaj periudhe u sqaruan edhe koncepte të keqkuptuara nga situata e sforcuar, si p.sh.: perceptimi i moratoriumit si falje e detyrimit kreditor nga banka, për periudhën në fjalë, apo realizimin e procesit të moratoriumit automatikisht për të gjithë klientët për periudhën në fjalë, duke mos aplikuar apo paraqitur në bankë, gjë që solli që një pjesë e klientëve të dilnin me vonesë ripagimi të detyrimit kreditor në këtë periudhe.

3 Moratoriumi në vetvete është shoqëruar me vendime lehtësuese dhe mbështetëse ndaj bankave tregtare, në eliminimin e efekteve që, në situatë normale, këto shtyrje do jepnin në pasqyrat financiare dhe parametrat e rrezikut, jo vetëm nga Banka e Shqipërisë, por edhe nga Autoriteti Bankar Evropian. Megjithatë, nuk mund të themi që këto masa, të vetme, garantojnë plotësisht mos-ndikim, pasi kjo lidhet gjithashtu drejtpërdrejt dhe me zhvillimet e mëtejshme të situatës ekonomike në vend, se si do të vijojë rimëkëmbja e bizneseve dhe mënyra se si ato do të operojnë nën një realitet, apo modalitet të ri. Nga ana tjetër, Raiffeisen Bank nëpërmjet strukturave solide që ka ngritur, ka ndërmarrë të gjitha masat për të shmangur, apo zbutur një situatë krize në të ardhmen.

4&5 Në vijojmë të mbështesim bizneset dhe individët, duke vlerësuar objektivisht dhe në zhvillim rrezikun e situatës, veçanërisht atë ndaj industrive më të prekura nga pandemia. Programet mbështetëse me fondet e garancisë sovraane ishin dhe janë mjete shumë të rëndësishme për financimin me hua në këtë periudhë. Duke qenë se Raiffeisen Bank operon edhe online, përveç degëve fizike, për aplikimet e huave është mundësuar marrja dhe përpunimi i aplikimeve të huave të reja. Sigurisht që ka pasur kërkesa për hua të reja gjatë kësaj periudhe, edhe pse në numër janë më të ulëta, krahasuar me periudhën para Covid-19. Prirja e tyre ka shënuar rritje, duke filluar nga muaji maj, ndërkohë një numër kërkesash kanë ardhur edhe përkundrejt garancive sovraane dhe ne jemi gati të mirëpresim dhe të përmbushim kërkesat e klientëve tanë.



TIRANA BANK

Glenda Kurti

Drejtoresh e Divizionit të Korporatave dhe Anëtare e Komitetit Ekzekutiv

Bankat tregtare kanë përshtatur strategjinë, prioritetet dhe buxhetin e tyre vjetor në mënyrë shumë të shpejtë në disa drejtime, si rezultat

i COVID-19 dhe zhvillimeve të fundit në vend, si dhe bazuar në udhëzimet e Qeverisë dhe Bankës Qendrore. Aktualisht, fokusi më i madh ka qenë në:

1. Masat e marra për shtyrjen e kësteve të huave, për bizneset që kanë hasur vështirësi financiare;
2. Financimi për pagat, siguruar me garanci sovraane.

Tirana Bank ka:

1. miratuar dhe po ofron instrumentin e financimit të pagave në biznese, e siguruar me Garancinë Sovraane, menjëherë pas firmosjes së marrëveshjes me Ministrinë e Financave & Ekonomisë;
2. aprovuar pjesën më të madhe të kërkesave të bizneseve për shtyrjen e kësteve të huave, menjëherë pas dhënies së udhëzimeve të Bankës së Shqipërisë;
3. vijuar veprimtarinë e huadhënies, në mbështetje të ekonomisë dhe individëve, sigurisht me një përqasje më të kujdesshme;
4. ofruar produkte specifike financimi, me kushte më të favorshme, adresuar punonjësve në fushën e mjekësisë dhe të rendit, të cilët mbeten në mënyrë të pandërprerë të angazhuar në përbalimin e situatës.

Instrumenti financimit me Garanci Sovraane është një alternativë që vlerësohet se do t'i vijë në ndihmë përmirësimit të situatës së likuiditetit të bizneseve dhe nevojave të tyre financiare në këtë periudhë. Nëse i referohemi dhjetëditëshit të parë, pas nënshkrimit të marrëveshjes, vihet re interes në rritje nga bizneset, që duan të bëhen pjesë e këtij financimi. Nga momenti i aplikimit dhe dorëzimit të dokumentacionit, bankat kanë një afat 10 ditor, deri në momentin e lëvrimin të fondeve, që do të thotë që koha në dispozicion është relativisht e kufizuar, duke pasur parasysh numrin e klientëve që mund të jenë subjekt i këtij financimi.

Tirana Bank, është në komunikim të vazhdueshëm me MF&E dhe institucionet përkatëse, duke u treguar shumë e kujdesshme, që kriteret e kualifikimit të klientëve për këtë financim të jenë të njëjta me ato të përcaktuara nga MF&E. Fondi i Garancisë, i caktuar për Tirana Bank, është 600,000,000 lekë, ndërkohë që fondi mujor i pagave të klientëve të biznesi, të paguara nëpërmjet bankës sonë, e tejkalon këtë shumë. Për këtë arsye, vlerësoj se ky fond garancie do të përdoret brenda afatit kohor të përcaktuar.

Klientët që kanë aplikuar për këtë financim kryesisht i përkasin kategorisë biznesi i vogël dhe i mesëm që operojnë në fushën e tregtisë, shërbimeve dhe prodhimit, fasoneri, turizëm, por nuk mungon interesi edhe nga biznesi i madh, aktiviteti i të cilit është ndikuar ndjeshëm gjatë javëve të fundit.



UNION BANK

Loreta Gogaj

Drejtoreshë e Departamentit të Biznesit SME

1 Objektivi dhe përparësia e stafit të Union Bank, gjatë këtyre muajve, ishte këshillimi dhe shërbimi ndaj klientëve për të mundësuar vazhdueshmërinë e transaksioneve

dhe veprimeve të ndryshme bankare. Informimi dhe orientimi i klientëve drejt platformave digjitale, komunikimi nëpërmjet telefonit, e-mailit, apo edhe drejtpërdrejt, ishte mjaft i rëndësishëm, si për transparencën, ashtu edhe për informimin e klientëve se si do procedonim me kërkesat e tyre kundrejt bankës. Mbi 1,000 klientë (individë dhe biznes) kanë bërë kërkesë për shtyrjen e pagesave të huas, apo ristrukturim për këtë periudhë afatshkurtë.

2 Problematikat kryesorë kanë qenë: mbyllja e biznesit, pamundësia për të lëvizur apo rënia e veprimtarisë tregtare, për shkak të mungesës së klientëve apo furnitorëve të tyre dhe kjo ka qenë e reflektuar pothuajse në çdo sektor. Sfidë më e madhe për këtë proces ishte sqarimi i keqkuptimeve të krijuara nga klientët për faljen e kredive kundrejt shpjegimit të një shtyrje të mundshme të kësteve dhe një plani të ri pagese që do të kishte klienti. Adresimi i një numri të madh kërkesash kundrejt një kuptimi individual për secilin prej tyre, duke u shoqëruar dhe me një shpjegim të ndryshimit kontraktual të klientit, përbente një sfidë për bankën dhe stafin e saj. Shtyrjet kanë vazhduar edhe gjatë muajit të fundit, pasi ka pasur klientë të cilët kanë pritur të studiojnë më mirë situatën dhe më pas të marrin një vendim, në varësi të ecurisë së biznesit, apo dhe parashikimit për vazhdimin.

3 Union Bank është e parapërgatitur për të analizuar dhe përballuar një situatë të tillë. Eksperiencia që kaluam në problematikat që solli tërmeti, na mësuan të analizojmë me kujdes çdo ekspozim kreditor dhe nevojë të klientit.

4 Pavarësisht situatës së krijuar, ka pasur biznese të cilat kanë vazhduar investimet e nisura, ose kanë dashur

të rinovojnë inventarin, në përputhje me sezonin. Kuptohet që kërkesa ka qenë më e moderuar se vitet e tjera dhe një vëmendje të veçantë gjatë kësaj periudhe ka marrë dhe Garancia Sovrane.

5&6 Në një situatë të tilla, ofrimi i një Garancie Sovrane, e cila synon ruajtjen e punësimit dhe rimëkëmbjen e biznesit janë më se të mirëpritura, si nga bankat ashtu edhe nga bizneset. Kushtet preferenciale dhe rimbursimi i interesit janë një nxitje e madhe për tërheqjen e kësaj huaje. Ky proces kërkon kohën e tij, prandaj këto skema duhet të jenë më të shtrira në kohë dhe t'u japin mundësi bizneseve t'i kuptojnë siç duhet dhe të kenë mundësi të aplikojnë. Ajo çfarë do të sugjeroja është që skema të tilla garancie të ofrohen edhe në vazhdim, por me kushte më të lirshme për bankat, që t'i përshtatin sipas tipologjisë dhe profilit të klientëve që kanë, në varësi të rrezikut që ato vlerësojnë. Kjo gjë do t'i bënte bankat të ishin më aktive dhe t'i përqaesohin klientëve që synojnë, sipas strategjive që kanë.



AMF – Drejtimi i ri për sfidat aktuale dhe ato në vijim

Modernizimi, konsolidimi i mëtejshëm, rritja e besueshmërisë dhe aplikimi i standardeve më të larta të mbikëqyrjes janë ndër sfidat që duhen përballuar cilësisht më mirë. Për vet natyrën e një vendi në zhvillim si Shqipëria, AMF ka rol domethënës në nxitjen dhe zhvillimin e tregjeve në mbikëqyrje dhe vlerësoj se ky është një rol që duhet theksuar.



Ervin METE

Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
(AMF)

Juve sapo jeni zgjedhur nga Kuvendi Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së. Nisur nga përvoja juaj dhe angazhimi pranë institucioneve financiare, si e vlerësoni sfidën e drejtimit të një autoriteti kaq të rëndësishëm rregullator të sistemit financiar shqiptar?

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare është një institucion që ka ardhur drejt një konsolidimi të vazhdueshëm në rolin e tij si rregullator dhe mbikëqyrës i tregjeve financiare jobankare, veçanërisht pas ndryshimeve ligjore të ndërmarra në vitin 2014, të cilat i forcuan pavarësinë institucionale. Si një nga dy mbikëqyrësit kryesorë të tregjeve financiare në vend, drejtimi i Autoritetit është sa privilegj aq edhe përgjegjësi. Modernizimi, konsolidimi i mëtejshëm, rritja e besueshmërisë

dhe aplikimi i standardeve më të larta të mbikëqyrjes janë ndër sfidat që vlerësoj duhen përballuar cilësisht më mirë. Krahas kësaj, për vet natyrën e një vendi në zhvillim si Shqipëria, Autoriteti ka rol domethënës në nxitjen dhe zhvillimin e tregjeve në mbikëqyrje dhe vlerësoj se ky është një rol që duhet theksuar.

Më gjerë, situata post-Covid-19, në varësi të shtrirjes së efekteve që do të ketë në ekonomi dhe jo vetëm, do të përcaktojë sfida domethënëse për autoritetet rregullatore. Edhe pse në fazën e parë duket se tregjet nën mbikëqyrje i përballuan relativisht mirë pasojat, është ende herët për të parashikuar ndikimin e plotë dhe ridimensionimet që mund të kërkojnë, në planin e ndërhyrjeve rregullatore. Megjithatë, situata pandemike nxorri në plan të parë disa domosdoshmëri, siç janë zhvillimi dhe diversifikimi i tregjeve për të përballuar më mirë goditjet, veçanërisht në tregun e sigurimeve, dhe nevoja për zhvillime rrënjësore teknologjike dhe digjitalizim.

Cilat mendoni se janë prioritetet për të ardhmen e afërt të AMF-së, lidhur me zhvillimin e tregut financiar në Shqipëri?

Zhvillimi i tregjeve nën mbikëqyrje mbetet objektiv kryesor. Tregu i sigurimeve, që përbën vetëm afro 1.4% të PBB, ka potenciale të mëdha për zgjerim dhe zhvillim të mëtejshëm. Pjesën më të madhe të këtij tregu e zënë aktualisht produktet e detyrueshme të sigurimit. Në vendet më të zhvilluara, një pjesë e

mirë e të ardhurave të këtij tregu vjen nga produktet vullnetare të sigurimit dhe ne kemi shumë hapësirë zhvillimi në këtë drejtim. Zgjerimi është i nevojshëm edhe sa i përket diversifikimit, për ta bërë industrinë e sigurimeve më rezistente ndaj goditjeve të mundshme.

Tregu i fondeve të investimit, gjithashtu, është një nga tregjet më të rëndësishëm nën mbikëqyrjen e Autoritetit, me një peshë prej rreth 3.9% në raport me PBB-në. Aktualisht, madhësia e mjeteve neto të fondeve të investimit është e krahasueshme me vendet e rajonit. Megjithatë, në krahasim me vendet e rajonit, numri i aktorëve të tregut, pra shoqëritë administruese, është ende i pakët.

Tregu i fondeve të pensionit vullnetar zë ende një peshë mjaft të kufizuar në raport me PBB-në, ku mjetet neto ndaj PB-së janë rreth 0.1%. Edhe në raport me këtë treg, Autoriteti ka propozuar disa ndryshime, lidhur me ligjin ekzistues. Megjithatë, duke marrë parasysh infrastrukturën e tregut në vendet e BE-së, do të jetë e nevojshme të ridimensionohet strategjia e zhvillimit të këtij tregu, sidomos në drejtim të planeve profesionale të pensionit (IORP).

Zhvillimi i tregut të kapitaleve, i cili është tregu që krijon mundësitë që fondet e investimit dhe fondet e pensionit të investojnë mjetet e tyre, mbetet një prioritet. Në Shqipëri, tregu i kapitaleve është në fazën e tij fillestare dhe Autoriteti, por edhe tregu, duhet ta shohin këtë fakt nga

ana pozitive. Kriza financiare e vitit 2008 nxori në pah shumë probleme, lidhur me sjelljen e shoqërive komisionare, abuzimin me tregun, apo transparencën e shoqërive të listuara. Pikërisht për këtë arsye, BE doli me disa direktiva të reja, siç janë direktiva e dytë e tregjeve në instrumente financiare (MIFID 2) apo direktiva dhe, më pas, rregullorja e abuzimit me tregun (MAR). Në tregun e kapitaleve është thelbësore transparenca. Në këtë aspekt, mendoj se është mundësia për ta zhvilluar këtë treg ashtu si duhet, duke mësuar nga eksperiencat pozitive dhe negative të vendeve të tjera.

Një prioritet tjetër është digjitalizimi, si në aspektin e raportimit në kohë reale të subjekteve nën mbikëqyrje, ashtu edhe sa i përket komunikimit ndër-institucional. Digjitalizimi, përveçse Autoritetit si rregullator dhe subjekteve nën mbikëqyrje, u shërben qytetarëve, përmes uljes së kostove dhe burokracive për marrjen e shërbimeve. Digjitalizimi është thelbësor për raportimin, inspektimin dhe e-shërbimet.

Mbrojtja e personave të siguruar dhe investuesve dhe rritja e besimit të tyre në tregjet në mbikëqyrje, nëpërmjet forcimit të rolit rregullator dhe sigurimit të një mbikëqyrje efektive me bazë rreziku, mbetet gjithashtu një prioritet për Autoritetin. Kjo, edhe në kuadër të rritjes së njohurive financiare, në funksion të garantimit të një mbrojtjeje më të mirë të investuesve dhe personave të siguruar.

Së fundmi janë miratuar disa akte shumë të rëndësishme që lidhen me zhvillimin dhe thellimin e mëtejshëm të tregut financiar shqiptar (ligji për tregun e kapitaleve, për skemat kolektive të investimeve dhe për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të

shpërndarë). Si e vlerësoni një zhvillim të tillë dhe çfarë ndikimi pritet që të japin këto zhvillime të reja ligjore.

Hartimi dhe miratimi i ligjit "Për Tregjet e Kapitalit" dhe "Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive" ishte domosdoshmëri, pasi të dy këto ligje përmirësojnë ndjeshëm kuadrin ligjor, duke e përshtatur atë ndaj dinamikës së zhvillimit të këtyre tregjeve. Këto dy ligje kanë për synim nxitjen e zhvillimit të mëtejshëm, rritjen e transparencës dhe sigurimin e integritetit të këtyre tregjeve. Ligjet janë hartuar me asistencën e Bankës Botërore, financuar nga SECO, dhe janë marrë në konsideratë direktivat dhe praktikatat më të mira të BE-së. Kam qenë personalisht i përfshirë në finalizimin e hartimit dhe miratimit të këtyre ligjeve dhe vlerësoj se krijojnë një platformë solide për zhvillimin e mëtejshëm të këtyre tregjeve.

Ligji "Për tregjet e kapitalit" përforcon kuadrin ligjor, duke vendosur kritere të forta për transparencë të të gjithë aktorëve të këtyre tregjeve.

Ligji "Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive" krijon hapësira për lloje dhe tipe të reja fondesh investimi, si për nga forma e strukturës (fondet furnizuese apo fondet ombrellë), ashtu edhe nga natyra (fonde alternative, ofruar klientëve profesionistë, etj.)

Ligji "Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë" rregullon infrastrukturën mbi bazën e së cilës funksionon teknologjia e regjistrave të shpërndarë, kushtet për licencimin, ushtrimin e veprimtarisë së operatorëve dhe bursave, si edhe mbikëqyrjen e tyre. Ai, gjithashtu, rregullon kushtet për emetimin dhe tregtimin e token-ëve digjitalë dhe monedhave virtuale, si dhe autorizimin nga autoritetet kompetente.

Në bazë të ligjeve të reja, Autoriteti

merr kompetenca për të kryer hetime administrative, bazuar në praktikatat më të mira ndërkombëtare. Ligjet e miratuara, që do të pasohen edhe nga hartimi i një sërë aktesh nënligjore dhe rregullatore përkatëse, forcojnë më tej kuadrin mbikëqyrës të Autoritetit, si edhe modernizojnë dhe zhvillojnë më tej tregun e kapitaleve në Shqipëri.

Çfarë mendoni se duhet të ndryshojë, apo zhvilluar më tej në rolin e AMF-së brenda sistemit financiar shqiptar për zhvillimin dhe thellimin e mëtejshëm të këtij tregu?

Tregjet financiare jobankare kanë pësuar një zhvillim me ritme relativisht të ngadalta, duke mbetur të kufizuara, si në raport me tregun bankar, ashtu edhe me tregjet e rajonit. Paralelisht me zhvillimin e tregjeve është zhvilluar dhe procesi i mbikëqyrjes dhe ai rregullator.

Zhvillimi i tregjeve do të sjellë një rritje të llojeve të subjekteve nën mbikëqyrjen e AMF-së, si dhe një larmi më të madhe në format e investimit nga këto subjekte. Kjo do të kërkojë ngritjeje kapacitetesh dhe aplikim të metodave bashkëkohore të mbikëqyrjes, duke u orientuar drejt mbikëqyrjes me bazë rreziku, me synim rritjen e besueshmërisë të rregullatorit dhe institucionet financiare.

Nga ana tjetër, zhvillimet e fundit në fushën e FinTech-save kanë bërë që të dalin një sërë produktesh dhe shërbimesh të reja, të cilat rrisin ndjeshëm eficiencën dhe shkurtojnë kohën e kryerjes së transaksioneve, te të cilat duhet pasur fokus dhe vëmendje. Këto zhvillime teknologjike diktojnë nevojën e kualifikimit profesional në vazhdim të punonjësve të Autoritetit, si dhe domosdoshmërinë për t'u përshtatur evolucionit të FinTech-save nëpërmjet modernizimit në mbikëqyrje dhe rregullim.

Bankat e të ardhmes: sfidat, vizioni dhe strategjitë

Nëse në të ardhmen e afërt, produktet bankare do të jenë gjithnjë e më pak të standardizuara e shabllone, e gjithnjë e më shumë të përshtatura me nevojat e klientëve, po kështu, edhe agjencitë bankare, apo “degët” e tyre duhet të evoluojnë në përputhje me këtë prirje.



Prof. Dr. Adrian CIVICI

REKTOR

UNIVERSITETI MESDHEHTAR I SHQIPËRISË

Ana “pozitive” e krizës së shkaktuar nga pandemia e Covid-19 lidhet me faktin se kjo goditje kaq e rëndë e shkatërruese, shërbeu njëkohësisht edhe si një provë rezistence themelore për “realitetin e ri post-coronavirus dhe transformimet e domosdoshme, që shumë sektorë ekonomikë e financiarë duhet të realizojnë, në mënyrë që të jenë performantë e konkurrues, në kushtet e reja në të ardhmen”. Nga ky rregull nuk bëjnë përjashtim as bankat.

Aktualisht, sektori bankar është në një proces transformimi rrethësor. Për të qenë më të saktë: në një transformim digjital radikal të filluar vite më parë, por që realitetet e reja kërkojnë që ai të jetë më i shpejtë dhe më i orientuar kundrejt paqartësive, rreziqeve dhe sfidave të reja. Inteligjenca artificiale dhe transformimet digjitale duket se do

jenë “kali i betejës” për bankat e së ardhmes në dekadën e ardhshme. Tashmë, të gjithë janë të bindur se bankat do jenë ndër sektorët dhe veprimtaritë pioniere të Revolucionit 4.0.

Veprimtaria bankare “klasike” do vijë vazhdimisht duke u reduktuar përballë veprimtarisë, hapësirave dhe mundësive që krijon digjitalizimi, teknologjitë e reja financiare dhe inteligjenca artificiale. Informacioni po bëhet më transparent, bota më e lidhur e më globale, shumë procese e shërbime bankare po bëhen të pavarura në kohë dhe në hapësirë. Falë teknologjisë klientët kërkojnë dhe shfrytëzojnë shërbimet bankare 24/7. Bankat online, që tashmë janë pagëzuar si “bankat e të ardhmes”, po zhvillohen me një shpejtësi marramendëse. Vlerësohet se, aktualisht mbi 50% e klientëve preferojnë t’i kryejnë shërbimet e tyre bankare online, kundrejt bankingut historik e tradicional. Interneti dhe smartphone-ët po ndihmojnë jashtëzakonisht në këtë prirje të re të neo-bankave, që shumë shpejt pritet të bëhet realitet i përditshëm.

Si pasojë e ndryshimeve të sjelljes dhe kërkesave të klientëve e konkurrentëve të rinj të sektorit bankar tradicional, përballë sektorit bankar po shtrohen një seri pyetjesh, përgjigjet e të cilave duhet të “përkthehen” shpejt në strategji dhe vizion e ri të bankave të së ardhmes: çfarë shërbimesh dhe cilësish të reja duhet të demonstrojnë dhe ofrojnë bankat? Cilat do të jenë

nevojat e klientëve në 5 apo 10 vitet e ardhshme? Si duhet të jetë “arkitektura” dhe imazhi i bankave të së ardhmes? Si do të gjendet ekuilibri i duhur midis teknologjisë digjitale (inteligjencës artificiale, robotikës, machine learning, etj.) dhe ndërveprimit njerëzor?

Përgjigjet e këtyre pyetjeve duhen kërkuar dhe gjetur në rradhë të parë te klientët, pastaj te zhvillimet teknologjike dhe situatat e reja të tregjeve financiare e bankare. Armiku më i madh i bankave në këto momente është e ashtuquajtura “sindroma Kodak”, mungesa e vullnetit dhe vizionit për ndryshimin e modelit të biznesit, dëmit nga “frika prej ndryshimit radikal” të domosdoshëm. Veprimtaria bankare tradicionale duhet të transformohet në një model biznesi ndër sektorial. Shërbimet bankare “të pastra” nuk janë më të mjaftueshme. Rentabiliteti, eficientia dhe diversifikimi duhet të jenë objektivat e rinj të çdo banke.

Tashmë, sidomos në këtë periudhë të re post Covid-19, “transformimi digjital” është kryefjala e çdo ndryshimi në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, apo shërbimeve të të gjitha llojeve. Për sektorin bankar bëhet fjalë për “rritjen e aftësisë parashikuese të nevojave”, “përmirësimin e shërbimeve”, “diversifikimin e ofertave dhe produkteve bankare”, “fitimi i klientëve të rinj nëpërmjet rrugëve digjitale”, “adaptimi me ciklet e biznesit dhe investimeve”, “përshtatja e shpejtë me flukset

financiare”, etj.

Por, krahas transformimit digjital që si objektiv kryesor ka klientin dhe diversifikimin e produkteve bankare, një nga sfidat më të mëdha të bankave të së ardhmes duket se do të jetë “revolucionin në funksionimin e tyre të brendshëm”, i përqendruar kryesisht te fluksi i informacionit dhe administrimi i të dhënave.

Ekspertë të sektorit bankar dhe transformimeve radikale që priten në këtë sektor, vlerësojnë se “ndryshimet e pritshme radikale në funksionimin e brendshëm të bankave të së ardhmes, duhet të konsiderohen si pjesa më strategjike e transformimit të tyre”. Dematerializimi i ofertës së shërbimeve bankare, si përgjigje ndaj evoluimit të kërkesave të klientelës, ishte përgjigja e duhur në këtë vorbull ndryshimesh të shpejta të sektorit bankar. Por, ky digjitalizim krijoi një “pasuri” të re për bankat: një masë të konsiderueshme të dhënash e informacionesh të vlefshme e të domosdoshme, për të përmirësuar akoma më tej shërbimin ndaj klientit dhe eficiencën e brendshme të funksionimit të bankave.

Ndërkohë, përtej “qasjes ndaj klientit”, kjo situatë e rendikoi shumë edhe në proceset e brendshme të funksionimit të bankave. Inteligjenca artificiale çoi në një rritje drastike të nivelit dhe numrit të proceseve të automatizuara brenda bankave. Sipas një studimi të McKinsey, 85% e proceseve të *back office* tashmë janë të automatizuara. Në vitet në vazhdim, kjo shifër pritet të jetë mbi 90%. Sfida më e madhe e bankave në këto momente, në muajt apo vitet në vazhdim, do jetë “rekrutimi i punonjësve të specializuar e kompetentë në teknologjitë e informacionit dhe inteligjencën artificiale”, apo një rikualifikim i shpejtë i një pjese të madhe të

personelit ekzistues në këtë drejtim.

Ky zhvillim i ri në sfidat dhe strategjitë e bankave të së ardhmes, do t'i detyrojë ato që të transformohen në “organizma, apo organizata me natyrë teknologjike” duke u prirur më shumë drejt rekrutimeve nga specialistët me profil informatikë e teknologji, se sa nga ata me profil të ngushtë financiar, apo bankar. Edhe vizionet e strategjitë menaxheriale të tyre pritet të ndryshojnë me shpejtësi. Sipas Boston Consulting Group, “transformimi rrënjësor digjital i bankave duhet të ecë paralel me transformimin e aftësive dhe kompetencave digjitale të personelit të tyre, si dhe duhet të mbështetet nga një vizion menaxherial po kaq adekuat”. Vetëm në këtë mënyrë, bankat mund të hynë të sigurt dhe eficiente në trasenë e së ardhmes të sektorit bankar.

Një nga sfidat themelore të bankave të së ardhmes është pa dyshim edhe adoptimi i sistemit “open banking”, i cili hap perspektiva të mëdha në rritjen e klientelës, përfshirjen e aktorëve të rinj në sektorin bankar, thjeshtimin e shumë proceseve e praktikave bankare, shërbimeve financiare të super personalizuara, etj., kuona të personalizuar për blerjen në dyqane e supermarkete të preferuara, thjeshtime për blerjet online, akses i shpejtë dhe i thjeshtë në sistemin e huave, këshilla të personalizuar për klientët, etj. Të gjithë këto shërbime mund të realizohen “pa mundim” në jetën e përditshme falë “open banking”.

Përtej anglishtizimit të këtij nocioni, idea është e thjeshtë: ky zhvillim është një mundësi e madhe që i ofrohet bizneseve të ndryshme, për t'u lidhur në mënyrë të sigurt me shërbimet bankare dhe klientët. Për klientët apo konsumatorët, “open banking” hap perspektiva të jashtëzakonshme shumë të thjeshta

pagesash, nëpërmjet telefonave celularë, apo tabletëve. Tashmë, një praktikë e tillë, akoma në fillimet e zhvillimit masiv të saj, po hedh bazat e një koncepti dhe praktike të re, të quajtur “financat e padukshme” ose “shërbimeve bankare pa banka”. Bankat më të mëdha evropiane, amerikane, aziatike, etj., po reagojnë me shpejtësi ndaj këtij fenomeni, nëpërmjet partneritetit, apo krijimit të platformave të tyre “open banking” duke shkuar drejt “krijimit të supermarketeve të mëdha financiare online, sipas modeleve të krijuara nga Amazon, apo Alibaba.

Një vizion dhe sfidë e re qëndron edhe përpara “konceptimit dhe funksionimit të agjencive bankare”. Nëse në të ardhmen e afërt, produktet bankare do të jenë gjithnjë e më pak të standardizuara e shabllone, e gjithnjë e më shumë të përshtatura me nevojat e klientëve, po kështu, edhe agjencitë bankare, apo “degët” e tyre duhet të evoluojnë në përputhje me këtë prirje. Koha e agjencive tradicionale me sportele, pas xhamave apo rrjetave të hekurit, me klientë në radhë dhe punonjës banke që komunikojnë me çdo klient, po shkon drejt fundit. Agjencitë bankare të së “nesërme” do të jenë krejt ndryshe, në funksion të evolucionit të digjitalizimit dhe kërkesave të klientelës. Ato do të ngjajnë më shumë me “një studio, apo sallon pritje të kompletuar, me ekrane digjitale, smartphone, kompjutera, etj., nëpërmjet të cilave klientët kryejnë veprimet, apo marrin shërbimet e duhura. Ato nuk do të konceptohen më si një agjenci bankare “që mbulon një zonë të caktuar urbane, apo rurale”, por do fillojnë të specializohen sipas segmenteve të klientelës: agjenci për shërbime ndaj studentëve, për shërbime ndaj bizneseve, për investime dhe projekte zhvillimi, për blerje produktesh specifike, etj.

JEPI VLERË KURSIMEVE DHE JETËS SUAJ!

PËRFITO:



SIGURIM TË JETËS DHE
AKSIDENTEVE NË GRUP



SIGURIM
I DETYRUESHËM



KARTË SHËNDETI
VJETORE

DEPOZITA
AFATGJATË

Hapni sot një depozitë afatgjatë në Tirana Bank,
dhe shihni se si kursimet tuaja rriten çdo ditë.

www.tiranabank.al

 **TIRANA BANK**
KËTU PËR JU

Shkëmbimi automatik i informacionit

Çfarë nënkupton për Shqipërinë dhe bankat shqiptare?

Qëllimi i raportimit të informacionit financiar është që të identifikohen lloje të ndryshme të ardhurash nga investimet, duke përfshirë edhe interesin, dividendët dhe lloje të ngjashme të ardhurash, si dhe të evidentojë situata kur tatimpaguesi kërkon të fshehtë të ardhura mbi të cilat janë shmangur tatimet.



Enkelejda TOTO

Kryespecialiste e Programeve dhe Kontrollit të Përputhshmërisë
Divizioni i Përputhshmërisë, AML & FCM
RAIFFEISEN BANK SHQIPËRI

Globalizimi me ritme të shpejta i ekonomisë ndërkombëtare është shoqëruar me një zgjerim të pashmangshëm të lëvizjes ndërkombëtare të kapitalit, mallrave, shërbimeve dhe individëve. Ky proces është shoqëruar me rritje të investimeve jashtë vendeve të rezidencës, e rrjedhimisht me menaxhimin e këtyre investimeve nëpërmjet institucioneve financiare në vendet pritëse. Këtu përfshihen edhe mbajtja e kapitaleve në vendet "offshore", një nga pasojat e të cilës është edhe mos përmbushja e detyrimeve tatimore në vendet e tyre të origjinës, pra evazion tatimor. Ky është një problem i madh për juridiksionet në të gjithë botën. Duke qenë se të gjitha shtetet kanë interes të përbashkët në ruajtjen

e integritetit të sistemeve të tyre tatimore dhe luftën ndaj evazionit tatimor, lindi nevoja e bashkëpunimit midis administratave tatimore për shkëmbimin e informacionit të llogarive financiare, për individë dhe ente, në bazë të disa rregullave të përcaktuara në formën e një standardi të përbashkët raportimi.

Në shkurt të vitit 2014, Ministrat e Financës së G20-ës dhe Guvernatorët e Bankave Qëndrore



Shqipëria nëpërmjet këtij legjislacioni dhe procesi ka në dorë një mjet shtesë dhe shumë efikas në luftën kundër evazionit tatimor, ndërsa sistemi bankar është një ndërmjetës i fuqishëm në këtë proces, i cili përfiton në radhë të parë një reputacion të fuqishëm, lidhje me integritetin e kryerjes së veprimtarisë financiare në treg.

miratuan Standardin e Përbashkët të Raportimit për shkëmbimin automatik të informacionit tatimor. Qëllimi ishte që të promovohen dhe zbatohen politika për stabilitetin ekonomik dhe financiar ndërkombëtar.

Shqipëria është anëtarësuar në Marrëveshjen Shumëpalëshe të Autoritetit Kompetent për

shkëmbimin e informacionit, me nënshkrimin e saj në tetor të 2014-ës dhe miratimin me vendimin nr.178 datë 09.03.2016, si dhe ka pranuar të shkëmbejë informacionin e llogarive financiare automatikisht në vitin 2020, me ligjin nr. 4/2020. Raportimi i parë në Shqipëri nga bankat do të jetë në 31 korrik 2020 dhe në vitet që do pasojnë do të jetë në fund të muajit maj të çdo viti.

Çfarë detyrimesh u dalin bankave shqiptare me këtë rast?

Në bazë të Ligjit nr. 4/2020, bankat shqiptare duhet të raportojnë çdo vit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve informacionin mbi llogaritë financiare të raportueshme, për individë dhe njësi ekonomike, si më poshtë:

Për individët: gjeneralitetet, juridiksion/in/et e rezidencës, gjendjen e llogarisë ose vlerën, shumën totale bruto të interesave të gjeneruara gjatë vitit, e të tjera të dhëna individuale sipas formularit.

Për entet: të dhënat e shoqërisë, emrin, juridiksion/in/et e rezidencës, TIN-in(et), numrin dhe gjendjen e llogarisë, shumën totale bruto të interesave të gjeneruara gjatë vitit, sipas tipit të llogarisë (kujdestarie, apo depozite), si dhe të dhëna për individin, pronar të fundit përfitues/personin kontrollues të një NFE pasive, ose Fondi Investimi, me seli në një vend/juridiksion jo-pjesëmarrës, sipas formularit përkatës.

Për të zbatuar këtë detyrim raportimi, bankave u ka lindur detyrimi i identifikimit të rezidencës

tatimore të klientëve, si dhe të numrit të identifikimit tatimor, sipas rezidencës tatimore. Një individ, apo ent mund të ketë një, ose më shumë rezidenca tatimore, e rrjedhimisht një ose më shumë numra identifikimi tatimor. Pra, dy janë detyrimet kryesore të bankave për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare: identifikimi i personave (individë dhe ente) të raportueshëm dhe raportimi i tyre.

Në mënyrë që të realizohet procesi i identifikimit dhe i raportimit, banka duhet të kryejë disa procese parapërgatitore dhe të ndërmarrë aksione në përputhje me kuadrin rregullator. Identifikimi i rezidencës tatimore të klientëve kryhet nëpërmjet formës së vetdeklarimit të klientëve. Bankave u del detyrimi i informimit të klientëve të tyre në lidhje me detyrimin për vetdeklarim të rezidencës tatimore, si dhe grumbullimin e këtyre formave brenda një afati të caktuar, sipas kuadrit rregullator në fuqi. Aktualisht në kushtet që jemi, procesi i raportimit të llogarive financiare te Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është me të vërtetë një sfidë për sistemin bankar.

Cilat janë detyrimet e Shqipërisë dhe autoriteteve shqiptare në këtë drejtim?

Shqipëria ka nënshkruar Marrëveshjen Shumëpalëshe të Autoritetit Kompetent për Shkëmbimin Automatik të Informacionit të Llogarisë Financiare. Kjo marrëveshje është miratuar me VKM nr.178, datë 9.3.2016 dhe parashikon që shkëmbimi i informacionit mund të kryhet mbi baza dy-palëshe nga autoritetet kompetente. Sipas marrëveshjes, Shqipëria duhet të fillonte zbatimin e shkëmbimit automatik të informacionit në fund të vitit 2018, por ky afat u shty për vitin 2020, për të pasur kohë për krijimin e bazës ligjore dhe të infrastrukturës së nevojshme për zbatimin e saj.

Për zbatimin e këtij detyrimi, duhet të vihet në funksionim një sistem, i cili do të shkëmbejë të dhëna konfidenciale ndërmjet administratave tatimore lokale dhe vendeve të rezidencës tatimore të deklaruar. Gjithashtu, duhet një bazë rregullatore për procedurat për vigjilencën e duhur, raportimin e informacionit nga institucionet financiare te Drejtoria e Tatimeve, si dhe masat për të siguruar zbatimin efektiv të ligjit.

Çfarë synon ky legjislacion dhe cilat janë përfitimet për sektorin bankar dhe vet Shqipërinë?

Synimi kryesor i këtij legjislacioni është evitimi i evazionit tatimor. Qëllimi i raportimit të informacionit financiar është që të identifikohen lloje të ndryshme të ardhurash nga investimet, duke përfshirë edhe interesin, dividendët dhe lloje të ngjashme të ardhurash, si dhe të evidentojë situata kur tatimpaguesi kërkon të fshehtë të ardhura mbi të cilat janë shmangur tatimet (p.sh.: duke kërkuar informacion mbi gjendjet e llogarive).

Legjislacioni synon që, përveç raportimit, të kufizojë edhe mundësitë që tatimpaguesit të shmangin raportimin përmes përdorimit të subjekteve juridikë ndërmjetës, ose strukturave të tilla. Pra, bankave dhe institucioneve financiare raportuese do t'u duhet të kryejnë një proces vigjilence të duhur dhe të zgjeruar.

Pra, Shqipëria nëpërmjet këtij legjislacioni dhe procesi ka në dorë një mjet shtesë dhe shumë efikas në luftën kundër evazionit tatimor, ndërsa sistemi bankar është një ndërmjetës i fuqishëm në këtë proces, i cili përfiton në radhë të parë një reputacion të fuqishëm, lidhje me integritetin e kryerjes së veprimtarisë financiare në treg.



TIK¹ - një nga elementët thelbësorë në tejkalimin me sukses të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19

Sektori bankar mund të konsiderohet si një nxitës kryesor dhe me ndikim të veçantë në evolucionin digjital, duke ndihmuar në rritjen e besimit të publikut në epokën digjitale.



Alketa LAMÇE

Drejtoreshë e Divizionit TIK
INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA

Situata e izolimit, e shkaktuar nga pandemia e COVID-19 krijoi një gjendje emergjente të pashembullt në Shqipëri dhe mbarë botën. Autoritetet Qeverisëse, Banka Qendrore, institucionet financiare dhe bizneset në vend përqendruan energjitë dhe burimet e tyre, duke reaguar shpejt në menaxhimin e krizës dhe ofrimin e zgjidhjeve të vlefshme, në përballimin së pari të situatës së emergjencës, por dhe të pasojave të mëtejshme të krizës, në vijim.

Gjatë kësaj periudhe kritike, përdorimi i internetit dhe teknologjisë u rrit në përmasa të jashtëzakonshme, duke marrë një rol vendimtar. Subjekte të ndryshme publike dhe private vunë në zbatim të gjitha njohuritë

dhe aftësitë e tyre teknologjike, për t'u përshtatur menjëherë me këtë realitet të ri. Objektivi parësor mbetej garantimi i vazhdimësisë së biznesit dhe zhvillimi i veprimtarisë, pa pasoja në cilësinë e shërbimit.

Ndonëse rregulloret dhe procedurat e MVV (Menaxhimit të Vazhdimësisë së Veprimtarisë) dhe RF (Rimëkëmbjes nga Fatkeqësitë) ishin të pranishme, situata të fatkeqësisë natyrore, me bllokim të plotë të lëvizjes, nuk ishin testuar me parë. Skenarë të gjendjes së fatkeqësisë natyrore, që kufizojnë paraqitjen në punë të stafit, apo aksesimin e zyrave prej tyre, zakonisht hartohen dhe testohen bazuar në standardet më të mira, siç janë: identifikimi i proceseve dhe stafit kritik të organizatës, identifikimi i një ndërtese të dedikuar, nga e cila në rast fatkeqësie këta punonjës mendohet të vazhdojnë veprimtarinë. Për më tepër, reagimi ndaj një fatkeqësie natyrore me një kohëzgjatje të tillë nuk ishte detajuar në planet MVV dhe RF të bankave.

Përvoja tregoi qartë se, përshtatja e menjëhershme dhe përgjigja e duhur ndaj këtyre sfidave u mbështetën tërësisht në aftësitë teknologjike, nivelin e digjitalizimit dhe maturinë së sigurisë së informacionit, brenda secilës organizatë. Përdorimi i gjerë i kanaleve digjitale u bë pothuaj i detyrueshëm dhe teknologjitë që mundësojnë lidhjen në distancë, si dhe sisteme të tjera ndërveprimi

(collaboration tools) e të menaxhimit të proceseve (workflow management), morën një rol parësor.

Si masë të parë dhe të domosdoshme në përgjigje të kufizimeve të bllokimit dhe kontrollit të pandemisë, organizata të ndryshme zbatuan konceptin e "punës nga shtëpia". Kjo mënyrë u mundësua nëpërmjet teknologjive efikase dhe pajisjeve të sigurta të komunikimit. Për shembull, teknologjitë që mundësojnë "Punën Fleksibël", të zbatuara që nga viti 2019 nga Intesa Sanpaolo Bank Albania dhe të përdorura më parë mbi baza vullnetare nga punonjësit e saj, ofruan zgjidhje shumë të vlefshme, gjatë periudhës së izolimit. Nëpërmjet teknologjive "Kompjuteri Virtual" dhe "Skype për Biznes" u mundësua krijimi i një force pune virtuale dhe plotësisht operative, një përgjigje optimale kjo ndaj kufizimeve të pranishme fizike të stafit në zyrat dhe degët e bankës.

Kryerja e veprimtarive jashtë orarit zyrtar, si p.sh.: monitorimi dhe ofrimi i shërbimeve TIK përgjatë 24/7, ekzekutimi i procedurave të mbylljes ditore dhe ofrimi i shërbimeve të tjera në ndihmë të klientëve, përbën një tjetër sfidë që u kapërcye me sukses vetëm falë teknologjive të veprimit në distancë.

Përdorimi i dendur i kanaleve digjitale gjatë kësaj periudhe, dëshmoi që, investimet e mëparshme në këtë fushë kanë qenë të duhurat. Ato mundësuan një rimodelim të

¹ Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit.

shpejtë të shërbimeve elektronike, për të zgjeruar aksesin dhe bazën e klientelës. Digjitalizimi kontribuoi gjithashtu në minimizimin e nivelit të ndërprerjeve të veprimtarisë, duke garantuar cilësinë e shërbimit në të gjitha nivelet. Zbatimi i një qasjeje të kombinuar, nëpërmjet të punuarit me prani fizike dhe virtuale të punonjësve, kërkoi mjete të efektshme monitorimi. Gjithashtu, u parashtua nevoja e dukshme për të përmirësuar proceset bankare dhe për të përsheptuar arritjen e një niveli të plotë digjitalizimi.

Për shkak të kufizimeve të vendosura në kohëzgjatjen e shërbimit, një mbështetje të konsiderueshme në menaxhimin dhe kontrollin e fluksit të madh të klientëve dhanë teknologjitë e "menaxhimit të pritjes në radhë" dhe ato të shërbimit të qendrave telefonike. Prezantimi dhe përdorimi online i pyetësorëve për punonjësit, garantoj zbatimin në kohë të protokolleve të përcaktuara nga autoritetet. Gjithashtu, përdorimi i mjeteve teknologjike mundësoi respektimin e distancimit fizik dhe zvogëlimin e distancimit social, duke mundësuar ndjekjen e mbarëvajtjes së stafit dhe klientëve të bankës.

Një sfidë tjetër, për sektorin bankar dhe strukturat e tyre TIK, lidhej me nevojën për të përballuar ndikimin e menjëhershëm ekonomik të krizës, si te klientët ekzistues ashtu dhe ata potencialë të bankës. Kërkesat rregullatore për të prezantuar procese dhe produkte të reja, si: aplikimi i moratoriumit të huave, instrumentet financiare të mbuluara me garanci sovraane, si dhe ekzekutimi në kohë i pagesave të "pagës së luftës", janë veprimtari të kryera me sukses gjatë kësaj periudhe falë proceseve të automatizimit, nëpërmjet teknologjive të ndryshme. Përshtatja e programeve dhe proceseve ekzistuese, të projektuara dhe të formalizuara që të shërbejnë edhe pas situatës së pandemisë, kontribuuan në dhënien e një përgjigje të strukturuar ndaj kësaj

sfide të re. Në këtë përvijim, kërkesat e klientëve u plotësuan siç duhet dhe në kohë, duke përbushur pritshmëritë e publikut të gjerë, por dhe vëmendjen e shtuar të autoriteteve dhe Bankës Qendrore.

Kriza ekonomike, e shkaktuar nga pandemia COVID-19 dhe efektet e saj, sfidat e të papriturat dhe mënyra se si u tejkaluan, ishin gjurmëlënëse për mjediset e biznesit dhe të punës, duke veçuar rolin e pazëvendësueshëm të Teknologjisë së Informacionit. Ajo theksoi, gjithashtu, rolin e proceseve



Nën vëmendjen dhe mbështetjen e duhur, kilometrat e fundit të "rrugëtimit drejt digjitalizimit" mund të përsheptohen. Një ndërgjegjësim më i lartë, si pasojë e situatës së krijuar, parashtroi nevojën për të lehtësuar kornizën rregullatore të shërbimeve digjitale dhe është tashmë në fokus dhe të aktorëve kryesorë, përfshirë institucionet qeveritare dhe entet publike.



fleksible dhe efikase, si dhe fushat me nevojë të menjëhershme për përmirësime dhe investime.

Kjo përvojë tregoi se, nën vëmendjen dhe mbështetjen e duhur, kilometrat e fundit të "rrugëtimit drejt digjitalizimit" mund të përsheptohen. Një ndërgjegjësim më i lartë, si pasojë e situatës së krijuar, parashtroi nevojën për të lehtësuar kornizën rregullatore të shërbimeve digjitale dhe është tashmë në fokus dhe të aktorëve kryesorë, përfshirë institucionet qeveritare dhe entet publike.

Gjithsesi, me gjithë ekzistencën e teknologjive të duhura, kornizës

ligjore dhe arritjeve të deritanishme në transformimin digjital, ende ka çështje që kërkojnë zgjidhje të menjëhershme. Më e rëndësishmja mbetet fuqizimi dhe shtrirja e nënshkrimit elektronik në distancë. Legjislacioni shqiptar që rregullon shërbimet digjitale (p.sh.: procesi i nënshkrimit elektronik në distancë i kontratave), i cili dhe pse trajton një pjesë të mirë të kushteve dhe pasojave, nuk është shterues dhe i konsoliduar, për sa i përket përcaktimit të procedurave juridike. Për më tepër, mungesa e akteve nënligjore, e sidomos e praktikës gjyqësore, lë hapësirë për paqartësi dhe interpretime jo të unifikuara.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm ka të bëjë me ekosistemin teknologjik të bankës së hapur (Open Banking), që po bëhet modeli i synuar operacional i bankave dhe do të shtyjë përpara transformimin digjital në vend. Përveç bizneseve dhe Bankës Qendrore, sistemet TIK të bankave kanë nevojë të ndërveprojnë edhe me mjediset teknologjike të autoriteteve (si p.sh.: e-Albania), me qëllim shkëmbimin automatik dhe në kohë reale të informacionit të nevojshëm të klientëve. Rrjedhimisht, në këtë drejtim nevojiten përmirësime teknologjike dhe ligjore, të cilat do të mbështesin bankat në ofrimin e një përvojë plotësisht digjitale për klientët e tyre.

Përbushja sa më e shpejt e këtyre nevojave të rëndësishme do të mundësojë krijimin e një mjedisi operacional dhe biznesi plotësisht digjital në Shqipëri. Për më tepër, sektori bankar mund të konsiderohet si një nxitës kryesor dhe me ndikim të veçantë në evolucionin digjital, duke ndihmuar në rritjen e besimit të publikut në epokën digjitale. Projektimi i një "normaliteti të ri" inteligjent do të kontribuojë në një ngritje të shpejtë pas krizës, si dhe do të ofrojë përparësi dhe mundësi të reja për bankat dhe bizneset drejt një të ardhmeje të suksesshme.

Sfidat e Auditimit të Brendshëm gjatë krizës Covid-19

Tashmë ekziston një mundësi e shkëlqyer që roli dhe funksioni i Auditimit të Brendshëm të jenë më të fortë dhe profesional, për t'i shtuar vlerat drejtimit të organizatave tona, duke i mbrojtur dhe përmirësuar ato, për të qenë biznes i shëndetshëm me korniza të reja kontrollesh dhe rreziqesh, por në të njëjtën kohë fleksibël dhe efektive.



Dorida STAMBOLLA¹

Drejtoresh e Auditimit të Brendshëm
RAFFEISEN BANK SHQIPËRI

Pandemia e Covid-19 po shkakton jo vetëm një krizë të shëndetit publik, por sjell me vete edhe një tronditje të madhe ekonomike dhe financiare me sfida të mëdha. Prodhimi i brendshëm bruto (PBB) pritet të ndikojë ndjeshëm në ekonominë në mbarë botën. Shkalla e tkurrjes në secilin vend do të varet nga fakti se sa i suksesshëm është ai vend në kufizimin e rritjes dhe parandalimit të valëve të dyta, ose të mëtejshme të këtij virus/i/esh, kohëzgjatjen e masave të zbatuara për të kufizuar kontaktin social e vazhdimësinë e punës nga shtëpia dhe efektivitetin

e veprimeve të ndërmarra, për të mbështetur ekonominë.

Pasiguria në vijim rreth ashpërsisë së krizës, zgjatja e recesionit dhe shpejtësinë e rikuperimit do ta bëjnë të vështirë vlerësimin e ndikimit të mundshëm të krizës në sektorin bankar. Sidoqoftë, fokusi tani do të jetë në rihapjen e ekonomive, bizneseve dhe bankave (me rreziqe



Puna nga zyra, apo nga ndonjë mjedis tjetër i largët (shtëpi, etj.) nuk ka më dallime, pasi pika e takimit me klientët/kolegët/audituesit tanë, është platforma në internet, si mënyra e re e punës dhe ofrimit të këshillave dhe rekomandimeve për të realizuar procese më të mira me kontrolle efikase.



të reja aktuale të shëndetit dhe sigurisë, pajtueshmërisë, ligjore, teknologjisë, operacioneve dhe mashtimeve etj.).

Në kontrast me krizat e tjera të mëparshme (2008/2009), bankat hynë në krizën shëndetësore me

kapital të fortë dhe likuiditet dhe menaxhuan trysinë mbi kapacitetet operacionale, duke aktivizuar planet e tyre të vazhdimësisë së biznesit. Sidoqoftë, është e qartë se kriza pritet të ndikojë në cilësinë e aktiveve, e rrjedhimisht edhe mbi përfitueshmërinë e bankave, nëpërmjet rritjes së nivelit të huave me probleme (NPL).

Hapat e kalimit drejt "një normaleje të re", të udhëhequr nga parimet shëndetësore dhe konsideratat ekonomike do të jenë tani e tutje në fokus të ekipeve drejtuese të bankave. Rruga nga pas-mbylljes së ekonomisë drejt normalizimit do kalojë përmes mësimave të marra, e kjo do të çojë në ide dhe mundësi të reja.

Kjo vlen edhe për rolin e Auditimit të Brendshëm. Këtu e rëndësishme është se si të zvogëlohen rreziqet në një mjedis të ri të kontrollit, duke edukuar palët e interesuara për ndryshimet e proceseve, procedurave, platformave, duke qenë këshillues më pro-aktivë, të përfshirë dhe të besueshëm për menaxhimin e bankës. Tri radhët e mbrojtjes së organizatave, do të duhet të përmirësojnë më tej komunikimin dhe bashkëpunimin ndër-funksional, pasi rreziqet dhe kontrollet tashmë janë ndryshuar dhe përshtatur me situatën e re. Bazuar në përvojën tonë, auditimit

¹ Kryetare e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në Shoqatën Shqiptare të Bankave (AAB). Anëtare Bordi në Institutin e Auditimit të Brendshëm në Shqipëri, pjesë e atij Global (IIA).

#Me_Ju_Çdo_Moment



 **UNIONBANK**
Banka që dua

Kryeni të gjitha shërbimet
bankare nga celulari dhe
qëndroni në shtëpi të sigurt.

të brendshëm nuk i është kërkuar të kalojë në radhën e parë ose/ dhe të dytë të mbrojtjes, gjë që do të rrezikonte pavarësinë e funksionimit të tij.

Tashmë është koha për të transformuar dhe digjitalizuar funksionin e Auditimit të Brendshëm. Ne të gjithë punojmë në distancë, por duhet të qëndrojmë të lidhur pasi mjetet dhe teknologjia janë gjerësisht të disponueshme, duhet të ecim përpara duke kuptuar ndryshimet brenda organizatave, duke rishikuar dhe përshtatur vlerësimet e planet tona të rrezikut, të përshtatemi duke i dhënë përparësi auditimeve të nevojshme dhe proceseve tona, të përdorim analiza të të dhënave në punën tonë të përditshme (analiza robotike e inteligjente të biznesit), të eksplorojmë aftësi të reja të punonjësve tanë dhe identifikojmë talentet në ekipet tona, të përdorim trajnime online, të transformojmë platformat tona teknologjike, të ndihmojmë organizatën dhe klientët tanë përmes të gjitha sfidave të reja.

Me "normalen e re" të punës së auditimeve në distancë, duhet të sigurohemi nëse ka auditime që kanë afate fikse të përcaktuara nga rregullatorët, për të cilat duhet të vazhdojmë më tej, për sa kohë që nuk komunikohen shtyrje/afate të reja nga rregullatorët. Mund të ketë auditime në fusha të cilat janë vendimtare dhe shumë të ngarkuara me vazhdimësinë e veprimtarisë dhe operacioneve të biznesit, për të cilat shtyrjet dhe riorganizimi i planit të auditimit mund të jenë zgjidhja më e mirë. Në këto kushte, duhet të përdoren vlerësimet e reja të rrezikut. Nisur nga përvoja, një zgjidhje mund të jetë që auditimi të aplikohet në një modalitet të

ndryshëm, siç janë: fushëveprimi i reduktuar dhe i përqendruar, afate të tjera, etj. Megjithatë, kjo varet nga struktura e organizatës, mjedisi ku punon auditimi, si dhe njësitë e të audituarve. Prandaj, kemi nevojë për një qasje rast-pas-rasti dhe prioritizim, duke qenë më fleksibël në kontrast me qasjen dhe planin tonë tradicional. Tashmë me situatën e re, lind nevoja e "auditimeve në distancë" jo vetëm gjatë fazave të përgatitjes dhe hartimit, por edhe në "periudhën e vizitave në vend" me intervista, verifikime e kontrole të dokumenteve të auditimit, nëpërmjet platformave online. Puna nga zyra, apo nga ndonjë mjedis tjetër i largët (shtëpi, etj) nuk ka më dallime, pasi pika e takimit me klientët/kolegët/audituesit tanë, është platforma në internet, si mënyra e re e punës dhe ofrimit të këshillave dhe rekomandimeve për të realizuar procese më të mira me kontrole efikase.

Maji është muaji ndërkombëtar (global) i ndërgjegjësimit mbi profesionin e Auditimit të Brendshëm brenda organizatës. Si i tillë, disa evente organizohen në të gjithë botën gjatë këtij muaji. Edhe këtu në Shqipëri, ne jemi një komunitet i konsiderueshëm i audituesve të brendshëm, si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik. Takime online, webinar-e, shkëmbime të përvojave etj., janë organizuar nga AAB, AIIA, universitetet, etj., me qëllimin kryesor që të qëndrojmë të lidhur, të menaxhojnë në mënyrën e duhur situatën dhe të promovojnë profesionin e Auditimit të Brendshëm në vend.

Sipas Përkufizimit të Auditimit të Brendshëm në Kornizën Ndërkombëtare të Praktikave

Profesionale të IIA (IPPF), ... *"auditimi i brendshëm është një veprimtari e pavarur, sigurimi dhe këshillimi e dizajnuar për të shtuar vlerën dhe për të përmirësuar operacionet e një organizate. Ai e ndihmon organizatën të përmbushë objektivat e saj, duke sjellë një qasje sistematike, e të disiplinuar, për të vlerësuar dhe përmirësuar efektivitetin e menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe proceseve të qeverisjes"*.

Këto janë periudha të jashtëzakonshme, që kërkojnë drejtim dhe profesionalizëm të jashtëzakonshëm. Tashmë ekziston një mundësi e shkëlqyer që roli dhe funksioni i Auditimit të Brendshëm të jenë më të fortë dhe profesional, për t'i shtuar vërtet vlera drejtimit të organizatave tona, duke i mbrojtur dhe përmirësuar ato, për të qenë biznes i shëndetshëm me korniza të reja kontrollesh dhe rreziqesh, por në të njëjtën kohë fleksibël dhe efektive.

Një thënie e Sokratit pohon se..."e vetmja gjë që di është se nuk di asgjë ... dhe se kontrollat e tua duhen përmirësuar" ose Volteri thotë..."nëse auditimi i brendshëm nuk ekziston, do të duhej të shpikej"!



Përtej Covid -19: Mundësi të reja për sektorin e FinTech-ut shqiptar

Përpos sektorit bankar, që është ndër aktorët më të rëndësishëm në bashkëpunim me EasyPay, gjatë muajve të fundit është rritur ndjeshëm ndërveprimi edhe me institucione të tjera, që synojnë digjitalizimin e shërbimeve dhe zgjerimin e klientelës së tyre, që favorizojnë dhe përdorin kryesisht kanalet e telefonit celular, për të kryer transaksione financiare.



Jonida KËLLEZI

Drejtoare e Departamentit të Marketingut
EASYPAY

Situata e krijuar krejt papritur nga pandemia botërore në fillim të vitit 2020, por edhe nga fakti se popullsia shqiptare ka një akses të ulët në shërbimet financiare, bëri që ndër të tjera Komisioni për Ekonominë dhe Financat të miratonte më 30 prill 2020, projektligjin "Për shërbimet e pagesave", i cili përaftron legjislacionin shqiptar me direktivat e Bashkimit Evropian dhe përqafon zhvillimet e teknologjisë financiare.

Për të rigjeneruar ekonominë dhe sektorët më të dëmtuar prej kësaj krize në Shqipëri, operatorët e pagesave pa diskutim që luajnë një rol tejet të rëndësishëm. Gjatë muajve të kaluar, ata u erdhën në ndihmë bizneseve shqiptare, sidomos atyre NMV, duke i ofruar zgjedhje në metodat e pagesave,

si dhe duke rritur përfshirjen financiare të popullsisë vendase.

Sfida e përballjes: FinTech shqiptare kundrejt Covid-19

Tregu i pagesave online edhe nëpërmjet përdorimit të telefonit ka arritur në ditët e sotme momentin e tij. Shoqëri të mirënjohura FinTechs, si: Paypal, Amazon Pay, Apple Pay, Alipay dhe Google Pay, kanë ofruar lehtësi në kryerjen e pagesave e shërbimeve financiare, veçanërisht në këtë periudhë, duke ulur kostot dhe burokracitë, e nga ana tjetër, duke ofruar komoditet, lehtësi, shpejtësi në veprim dhe mbi të gjitha siguri nga kryerja e veprimeve nga shtëpia. Krahasimisht të njëjtën gjë pritet të krijojë edhe ligji "Për shërbimet e Pagesave" në vendin tonë. Ai do të jetë: një rregullues mjaft i mirë veçanërisht për shoqëritë FinTech; një promotor i konkurrencës novatore në sektorin financiar dhe atë online; si dhe do të garantojë mbrojtjen e të dhënave të klientëve, nëpërmjet zbatimit të masave të sigurisë, si: verifikimi multifaktorial.

Tashmë prej 10 vitesh EasyPay sjell lehtësi për konsumatorë e biznese shqiptare në kryerjen e pagesave të shërbimeve utilitare, si: pagesën e faturave të energjisë dhe ujit, taksave, rimbushje celulari, pagesat e telefonisë fikse, internet dhe IPTV, pagesat e kësteve të mikrokredive, si dhe pagesat e biletave për evente të ndryshme. Veçanërisht, në mars 2020 numri i transaksioneve në platformën

EasyPay u dyfishua, ndërkohë që numri i klientëve të rinj u trefishua.

Nëse do të shohim me pozitivitet përtej krizës së krijuar nga Covid-19, mund të themi se konsumatorët do të kthehen me shumë gjasa drejt sektorit të Fin-tech-save, për tre arsye kryesore: kosto më të ulëta, thjeshtësi në përdorim si dhe shërbim më i shpejtë në kohë reale!

"Fin-tech or die"

Modeli që EasyPay ofron për të rritur përfshirjen financiare dhe bashkëpunimin me sektorë të ndryshëm të ekonomisë në vend është: Përqendrimi/fokusimi në shërbime digjitale: pagesat kryhen nga kanalet digjitale dhe telefonat inteligjentë (në kohë reale); integrim të thjeshtë (API të gatshme); një rrjet të gjerë agjentësh e dyqanesh (sidomos për depozitim dhe tërheqje); procese të automatizuara dhe kosto të ulëta. Ky model i vjen në ndihmë sfidës që Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me institucionet e tjera shtetërore dhe Bankën Botërore, synojnë të realizojnë deri në vitin 2022. Më konkretisht, dy janë objektivat strategjike të vendosura:

- 1) Arritja e koeficientit të 10 pagesave me para' jo-fizike për frymë (nga 4.3 që është aktualisht), dhe
- 2) Arritja e një raporti të disponimit të një llogarie bankare/paraje elektronike, në vlerë 70% (nga 40% që është aktualisht).

Përpos sektorit bankar, që është

ndër aktorët më të rëndësishëm në bashkëpunim me EasyPay, gjatë muajve të fundit është rritur ndjeshëm ndërveprimi edhe me institucione të tjera, që synojnë digjitalizimin e shërbimeve dhe zgjerimin e klientelës së tyre, që sipas McKinsey Global Institute gjenerata e re (fondi i GenX dhe Mijëvjeçarasi) favorizojnë dhe përdorin kryesisht kanalet e telefonit celular, për të kryer transaksione financiare.

Konkretisht, në 2020 në platformën e EasyPay janë shtuar bashkëpunimet me institucionet e mikrokredisë, si: NOA dhe IUTE Credit, të cilët vlerësojnë rëndësinë e digjitalizimit të shërbimeve të tyre dhe përfituan nga rrjeti i gjerë i shpërndarjes (agjentëve) të EasyPay (sidomos për zonat larg qendrave). Për më tepër, gjatë muajve të parë të 2020-ës, EasyPay zgjeroi portofolin e shërbimeve, duke hyrë në tregun e sigurimeve. I licencuar nga AMF si agjent i disa prej shoqërive më të mëdha në industri, këtë rrugëtim EasyPay e filloi me Sigal Uniqa Group Austria. Sukses i këtyre bashkëpunimeve qëndron në optimizimin e eksperiencës konsumatore. Duke vendosur veten nën petkun e konsumatorit, skuadra EasyPay ideoi dhe krijoi shërbime e produkte digjitale që përmbushin nevojat financiare në treg.

Risitë post Covid

Çështja kryesore gjatë tremujorit të parë të fillimit të vitit për çdo shoqëri në treg ishte menaxhimi i të panjohurës! Situata e krijuar nga pandemia botërore e Covid-19 dhe masat drastike të izolimit, të ndërmarra nga të gjithë qeveritë në botë, ndikoi në zhvillimet e tregjeve. Megjithatë, kjo situatë solli mundësi të reja për bizneset FinTech, bashkëpunime me sektorë të rinj dhe krijim të produkteve/shërbimeve të reja.

Konkretisht, gjatë periudhës së izolimit dërgesat e parave u bënë një mision i vështirë. Në shumë shtete, agjentët/pikat e shërbimit për transferime parash punuan me kufizime, duke krijuar radhë të gjata, e njëkohësisht orët e veprimtarisë ishin të shkurtra. Eksperienca disa vjeçare në tregun e dërgesave me partnerin global RIA Money Transfer, i ofroi mundësinë EasyPay të zhvillojë këtë shërbim nëpërmjet teknologjisë: transfera momentale të parave (instant payment) nëpërmjet celularit dhe agjentëve. Ky shërbim që pritet të dalë "live" në fund të verës, do t'i vijë në ndihmë individëve dhe bizneseve që ndodhen veçanërisht në zona larg bankave, ATM-ve dhe operatorëve të pagesave, për të rimbursuar një klient për një shërbim të anuluar, paguar dikë për blerje ushqimore, dërguar para te fëmijët, ose prindërit, etj.

Megjithëse duhej të kishte ndodhur kohë më parë, u desh kjo situatë që bizneset shqiptare të integrojnë teknologjinë në strategjitë e tyre. Eksperienca e këtij fillimviti tregoi se në Ballkan,

e veçanërisht në Shqipëri, ku ekosistemi FinTech duhet ende të konsolidohet, institucionet shtetërore duhet të luajnë një rol më aktiv dhe gjithëpërfshirës, për të arritur një bashkëpunim më të gjerë midis konsumatorit, aktorëve të rinj financiarë, sistemit bankar si dhe bizneseve NMV. Teknologjia është këtu për të mundësuar "shërbime të lehta për t'u kuptuar dhe aksesuar nga kushdo, të cilat ulin kostot e përdoruesve dhe barrierat e aksesimit prej tyre". Duke përmirësuar aksesin dhe lehtësinë e shërbimeve financiare për individët dhe bizneset, përfshirë këtu bizneset e vogla dhe ato të mesmet, teknologjia promovon zhvillimin ekonomik.

EasyPay do t'i qëndrojë besnik objektivave strategjike të së ardhmes dhe do vazhdojë në këtë mënyrë të thjeshtë ndërveprimin financiar midis konsumatorit dhe biznesit me anë të produkteve dhe shërbimeve online, duke arritur në këtë mënyrë, gjithë përfshirjen financiare të shoqërisë nga njëra anë dhe krijimin e një grupi të ri konsumatorësh nga ana tjetër!





INVESTONI TË SIGURTË DHE FITONI ME NE

Aksioneri kryesor - IDB

Institucion Ndërkombëtar Financiar
i **Klasifikuar me AAA**



DEPOZITA
ME AFAT 5 VJEÇAR

3.2% në Lekë
Fitim i pagueshëm në fund të çdo viti

Trajnimet - sfidat dhe mundësitë në kushtet e pandemisë



Junida Tafaj

Oficere Operacionesh
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE, AAB

Pandemia ndryshoi krejtësisht mënyrën tonë të të punuarit dhe njëkohësisht edhe të menaxhimit të të mësuarit, e të zhvillimit brenda organizatës. Lindi një nevojë urgjente për përshtatje me një realitet të ri. Edhe pse mund të duket disi e pavend të shkruash për trajnimet, në një kohë kur flitet për pasojat ekonomike që shkaktoi pandemia, nuk duhet harruar se çështja e vazhdimësisë së trajnimeve dhe zhvillimit janë thelbësore.

Por si mund të garantoni vazhdimësinë, kur çdo gjë u ndërpre së funksionuarit? Ishte e qartë që në fillim: sigurimi i të mësuarit në distancë kërkonte më shumë sesa thjesht takime në Skype, apo regjistrime videosh; nuk mund të zëvendësohet kaq thjesht të mësuarit ballë për ballë me atë online! Nuk mund të bëhen të njëjtat gjëra, thjesht duke përdorur një metodë të ndryshme. Ne duhej tashmë të ndryshonim mënyrën se si e perceptonim ndërtimin e njohurive.

Pas ndërprerjes së veprimtarive të planifikuara duhej të rishikonim kalendarin e mëparshëm dhe të

vlerësonim nëse nevojat kishin ndryshuar. Njëkohësisht, trajnerët duhej të rishikonin metodologjinë përkundrejt rezultateve dhe nëse ato ende funksiononin për realitetin e ri. Të vetëdijshëm që ndërveprimi me pjesëmarrësit kërkonte një punë përgatitore dhe jo thjesht komunikimin e zakonshëm, filluam të planifikonim seanca paraprake për të mbështetur pjesëmarrësit individualisht, ose në grupe të vogla, për të praktikuar ose konfirmuar të kuptuarit e teknologjive që do të përdoren për trajnimet online.

AAB bashkëpunon prej vitesh me partnerë lokalë dhe ndërkombëtarë, për të kontribuar në ndërtimin e kapaciteteve të sektorit financiar. Përpos situatës, AAB ia doli mbanë dhe njoftoi në fund të prillit 2020 trajnimet e para online. Ne vendosëm që të kishim grupe në madhësi të menaxhueshme; klasat virtuale janë shumë sfiduese në ekipe të mëdha. Ne i këshilluam ekspertët që të fillonin me prezantimet për t'i njohur pjesëmarrësit me komoditetin e teknologjisë dhe gjithashtu për të planifikuar diskutime e ndërveprime të hershme, për të provuar lidhjen, si një mënyrë për ndërtimin e angazhimit gjatë seancave të mëtejshme.

Qëllimi ynë mbetet ai i organizimit të klasave virtuale, të ngjashme me klasat ballë për ballë: ato duhet të jenë tërheqëse, ndërvepruese dhe të japin rezultate.

Ndërkohë që rihapja, apo heqja e masave të ndërmarra dhanë shpresë për rifillimin e veprimtarive në vend, kufizimet e "përkohshme" të udhëtimeve, që kanë mbyllur qiellin e Evropës, janë ende në fuqi dhe duket se do të mbeten në fuqi për një kohë të paparashikueshme. Vështirësitë logjistike dhe disponueshmëria e kufizuar e ekspertëve ndërkombëtarë

e bëjnë të pamundur rifillimin normal të trajnimeve me prani fizike, deri në muajin shtator.

Gjithsesi, falë bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë: ATTF dhe House of Trainings (Luksemburg), si dhe me mbështetjen financiare të Qeverisë së Luksemburgut, lançuam "Kalendarin e trajnimeve në distancë", duke krijuar kështu mënyra të reja të të mësuarit, për të mundësuar vazhdimin e transferimit të njohurive të ekspertëve ndërkombëtarë, pavarësisht nga vështirësitë aktuale. Kurset janë të ndara të dy kategori kryesore: klasat virtuale dhe e-mësimi (e-learning), ku të gjithë aplikuesit nga sektori i bankar do të bëhen pjesë e klasave ndërkombëtare, të organizuara me profesionalizëm nga ekipi i ATTF-së.

Gjithashtu, për herë të parë në bashkëpunim me AIEEx, organizuam edhe trajnim online në gjuhën shqipe me ekspertë shqiptarë, në një platformë profesionale të të mësuarit, të quajtur AIEEx LMS. Nga ana teknike, AIEEx LMS-ja u mundëson trajnerëve, të lëvizin njëkohësisht midis detyrave e përshtypjeve, duke i ndarë dhe mbikëqyrur ato. Pjesëmarrësit i marrin mbrapsht menjëherë vlerësimet e tyre.

Trajnimi ballë për ballë, i drejtuar nga trajneri, mbetet metoda e parapëlqyer, pasi ndërveprimi njerëzor është i rëndësishëm. Në një kohë kur shumë organizata nuk e braktisin mënyrën konvencionale, mësimi tradicional ballë për ballë kombinohet me metoda e-learning, në mënyrë që pjesëmarrësit të arrijnë potencialin e plotë. Në thelb, qëllimi është të nxisim ndryshimin e vërtetë, duke e angazhuar stafin.

Tashmë i kemi të gjitha modelet, elementet dhe mjetet, për të siguruar mundësi mësimi online; thjesht na duhet të fillojmë punën e vështirë për t'i përdorur ato me eficiencë.

OBJEKTIVAT PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM




ABI Bank:



- Në 24 prill dhuroi tri pajisje respiratore për terapi intensive, të cilat i shkojnë në ndihmë sistemit shëndetësor për të rritur kapacitetet e tij në përballjen me situatën e krijuar nga COVID-19.
- Mbështeti Spitalin Rajonal të Durrësit me materiale dhe veshje mbrojtëse për personelin shëndetësor.
- Gjatë muajve prill-maj, në përgjigje të kërkesave të Kryqit të Kuq Shqiptar, Bashkisë Kamëz dhe Shoqatës për Integrimin e Pensionistëve të Shqipërisë, dhuroi mbi 600 paketa ushqimore për familjet shqiptare në nevojë dhe pensionistët e vetmuar në kushte të varfërisë ekstreme, në Tiranë, Vorë, Kamëz dhe Paskuqan.
- Mbështeti për të dytin vit radhazi, serinë e Podcast-eve: "Shqiptarët e Mrekullueshëm", një bashkëpunim i ABI Bank me Rudina Xhungën, që sjell histori suksesi të shqiptarëve brenda dhe jashtë vendit.

e Tregtisë dhe Industrisë Shqipëri - Turqi (ATTSO).

- Mbështeti Qendrën e Botimeve për Diasporën për publikimin e Fjalorit Shqip-Ukrainishte, i cili është botuar dhe shpërndarë për fëmijët e diasporës shqiptare deri në 6 vjeç në Ukrainë, me qëllim promovimin e gjuhës shqipe për fëmijët e diasporës në Ukrainë, si dhe 14 përralla klasike të përshtatura në gjuhën shqip dhe ukrainisht për grupmoshat 5-8 vjeç. Këto përralla janë botuar në 7 libra të ndryshëm dhe janë shpërndarë në diasporën shqiptare.



- Credins Bank iu bashkua Kryqit të Kuq, dega Tiranë, në dhurimin e disa pakove ushqimore për familjet në nevojë, përgjatë periudhës së pandemisë.
- Mbështeti Operatorin e Kujdesit Shëndetësor duke dhuruar disa kompjutera për përmirësimin e kushteve të punës dhe infrastrukturës së këtij institucioni.
- Mbështeti projektin "Ballkone të Gjelbër", në bashkëpunim me organizatën "Njerëz dhe Ide" dhe Bashkinë Tiranë, një nismë për të rritur ndërtimin e hapësirave të gjelbra në ballkonet e kryeqytetit dhe për t'i kthyer ballkonet në një hapësirë të këndshme për çdo familje dhe një kënd pune shlodhës.
- Iu bashkua nismës së Bashkisë Krujë për të rritur gjelbërimin në qytet.
- Mbështeti Ambasadën e Republikës së Shqipërisë



Banka Kombëtare Tregtare:

- Dhuroi pajisje për të përmirësuar infrastrukturën e IT-së, duke synuar nxitjen e inovacionit teknologjik në institucionet: Drejtoria Rajonale Arsimore Rrogzhinë, Bashkia Liqenas dhe I EVP Peqin.
- Në kuadër të fushatës ndërgjegjësuese për parandalimin e përhapjes së COVID-19, mbështeti Dhomën

në Maqedoni në blerjen e 4 botimeve të "Testimonial from the Presidential Cabinet", duke demonstruar mbështetje ndaj artit, si një sektor i rëndësishëm për rritjen e ndikimit të artit dhe kulturës në shoqëri.

- Mbështeti realizimin e eventit "VIZart", një ekspozitë që bën bashkë punët e 50 mjeshtrove shqiptarë, që i përkasin brezave të ndryshëm, që nga Kodra, Jukniu, Kilica, Dhrami, Shoshi, Lulani, Keraj, Madhi, Mele, Leka, e shumë artistë të njohur, duke përfshirë dhe organizatorin e kësaj ekspozite z. Helidon Haliti.
- Mbështeti "Konkursin e bizneseve të gjelbra", në bashkëpunim me Partners Albania, i cili promovon inovacionin, duke shfrytëzuar burimet lokale, nxitur zhvillimin e ekonomisë, rritjen e punësimit, dhe ndërtimin e një rajoni sa më të gjelbër. "Rinora Handmade" si një nga fituesit e këtij konkursi, u mbështet për zgjerimin e biznesit me produkte të reja.




- Gjatë njoftimit të mbylljes për shkak të pandemisë globale Covid-19, Fibank Albania nisi në median sociale lojën #fotofamiljaregazmore, deri në prill. Qëllimi i kësaj loje ishte të ftonte njerëzit të sjellin imazhe nga familjet e tyre gjatë kësaj periudhe, e në të njëjtën kohë, të ishin pjesë e një konkursi fitues.
- Gjatë periudhës së mbylljes, Fibank ndërmoi të gjitha masat e nevojshme të

sigurisë, në përputhje me udhëzimet e qeverisë, për të mbrojtur jetën e aseteve të saj më të rëndësishme: stafin dhe klientët e Fibank.


- Fibank lançoi produkte për t'i shërbyer më mirë nevojave të klientëve gjatë situatës pandemike, si vijon:
 - Pensionet në shtëpi – bashkëpunoi me Postën Shqiptare, për dërgimin e pensioneve në shtëpitë e pensionistëve, në mënyrë që të minimizojë ekspozimin e degëve.
 - lëshimin e menjëhershëm të kartave të debitit/kreditit pa kontakt - duke u mundësuar klientëve të minimizojnë kontaktin e përditshëm me paratë e gatshme.
 - llogaritë rrjedhëse speciale për të gjithë punonjësit e prekur që marrin ndihmë nga paketa e ndihmës qeveritare.

Këto produkte u mundësuan klientëve të minimizojnë kontaktin e përditshëm me paratë e gatshme dhe të kenë qasje të menjëhershme në fondet e tyre në llogaritë bankare.

- Fibank Albania iu bashkua fushatës humanitare të Down Syndrome Albania **#Bashkepertendihmuar**, duke ndihmuar me paketa ushqimore dhe të higjienës për 60 familje në nevojë, në rajonin e Matit që mbulojnë fshatrat German, Suat, Komsj, Burgajet, Derjan, Shulbater dhe brenda qytetit të Burrelit, si mjet për të lehtësuar efektet e pandemisë.



- Më 23 prill, Banka u dërgoi një kartolinë ndërgjegjëse punonjësve mbi Ditën Ndërkombëtare të Librit dhe të Drejtave të Autorit me sloganin: Librat janë një dritare për të parë Botën!
- Më 28 prill u promovua Dita Botërore e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë.
- Banka ideoi nismën “Share your Smart Story” ku ftoheshin të gjithë kolegët e grupit të cilët punonin nga shtëpia, të sillnin përvojat e tyre personale gjatë periudhës së karantinës.
- Më 1 maj, Intesa Sanpaolo Bank Albania përcolli një mesazh të veçantë falënderimi për punonjësit e saj, veçanërisht për të gjithë ata që nuk e ndalën punën asnjë çast.
- Gjatë ditëve të pandemisë kur çdo lëvizje ishte e limituar maksimalisht, grupi organizoi një set udhëzues të quajtur Digital Coach – Trajnuesi Dixhital, i cili shërben si një instruktor shumë i mirë mbi mënyrën se si duhet ta organizojmë një ditë pune në distancë, pa humbur vëmendjen ndaj kujdesit për shëndetin duke ruajtur balancat e brishta punë-jetë.
- Më 15 maj u promovua Dita Ndërkombëtare e Familjes.
- Më 17 maj në Ditën Ndërkombëtare të Teknologjisë dhe Informacionit, ka mundur një sërë shërbimesh online si edhe vazhdimin e punës dhe shkollës nga shtëpia në të gjithë botën.
- Më 21 maj u promovua Dita Botërore për Diversitet Kulturor, për Dialog dhe Zhvillim.
- Më 22 maj u promovua Dita Ndërkombëtare e Biodiversitetit.
- Duke synuar të ofrojë mbështetjen e saj në këtë periudhë të vështirë, mirëpret në të gjitha degët e saj në Shqipëri të gjithë qytetarët të cilët kanë të drejtë të përfitojnë nga ndihma financiare dhe ofron paketën e mëposhtme:
 - Hapja/Mbyllja e llogarisë rrjedhëse – Falas
 - Nuk kërkohet balancë minimale në hapjen e llogarisë rrjedhëse
 - Platforma Digital Banking – Falas
 - Llogaria Rrjedhëse dhe Karta Debiti VISA INSPIRE pa tarifa mirëmbajtjeje mujore.
- Më datë 1 qershor u promovua Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve.
- Më datë 5 qershor u promovua Dita Ndërkombëtare e Mjedisit.
- Banka për të tërhequr vëmendjen e publikut mbi rëndësinë e sigurisë online shpërndau nëpërmjet faqes së saj zyrtare në FB shembuj të ndryshëm të mashtrimeve online dhe mënyrën se si mund të parandalohen ato.
- Më datë 8 qershor u promovua Dita Botërore e Oqeanëve.
- Më 14 qershor në Ditën Botërore të Dhuruesve të Gjaku, një grup punonjësish të Bankës si dhe dy bashkëshorte të tyre, dhuruan gjak për fëmijët talasemikë pranë mjedisëve të një laboratorit privat të vëna në dispozicion nga dr. Natale Capodicasa.
- Më 20 qershor u promovua Dita Botërore e Refugjatëve.





Banka u përfshi në dy konkurse të përvitshme, të organizuara nga Tirana Business University (TBU):

- **Sipërmarrësit e së Nesërmes, Edicioni 10** – ku pjesëmarrësit prezantuan, individualisht ose në skuadra, ide biznesi të shtjelluara në format të thjeshtuar plan-biznesi;
- **Juristët e së Nesërmes, Edicioni 6** – në të cilin individë, ose skuadra, prezantuan kërkesë-padi dhe mbrojtje/prapësime për një kauzë juridike/çështje ligjore.

Banka OTP Shqipëri mbështeti financiarisht një prej çmimeve të para që ju akordua konkurrentëve pjesëmarrës në këtë veprimtari, si dhe u bë pjesë aktive e jurive që vlerësuan cilësitë dhe krijimtarinë e prezantimit të idesë.




Raiffeisen Bank:

- Mbolli 250 pemë në aksin rrugor Kombinat-Vaqarr, në mbështetje të projektit të Bashkisë Tiranë për shtimin e hapësirave të gjelbra në kryeqytet.
- Në bashkëpunim me Forumin e Mendimit të Lirë u ndërморën 4 aksione për pastrimin e Plazhit të Spillesë, Tales, Zverneçit dhe plazhit në Gjirin e Lalëzit. Një kontribut të veçantë në këto aksione, si çdo vit, dha edhe stafi i bankës.
- I dhuroi Spitalit Rajonal Durrës disa pajisje mbrojtëse si: maska, veshje speciale dhe syze mbrojtëse, duke iu gjendur pranë bluzave të

bardha të këtij spitali.

- Një vëmendje të posaçme ia kushtoi të moshuarve që jetojnë të vetmuar, apo në vështirësi ekonomike, duke dhuruar 350 pako me ushqime.
- Mundësoi pajisje kompjuterike për zyrat e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët, që ka në fokus kryerjen e studimeve dhe publikimeve për komunitetin arbëresh.
- Me rastin e 20 majit, Ditës Kombëtare të Fëmijëve Jetimë, mundësoi organizimin e shfaqjes me kukulla "Bilbili dhe Trëndafili" për fëmijët e Shtëpisë së Fëmijës "Zyber Hallulli", Tiranë. Kjo shfaqje u mbajt në vazhdim edhe në disa shtëpi fëmijësh dhe qendra sociale, në të gjithë Shqipërinë.
- Mbështeti Teatrin Kombëtar në kalendarin artistik të vitit, shfaqjet on-line të projektit: "The show must go on", si dhe produksionin artistik kushtuar të rinjve: "TK RIN ART ON".
- Mbështeti kalendarin artistik të Teatrit të Kukullave, duke bërë të mundur argëtimin dhe edukimin e brezave të rinj nëpërmjet artit.



TIRANA BANK

- Në bashkëpunim me Bashkinë e Kamzës shpërndau shporta ushqimore për 100 familjet më në nevojë në zonën e Kamzës.
- Tirana Bank i siguroi Qendrës Shëndetësore të zonës së Piskovës, Përmet pajisje dhe mobilimin e brendshëm.
- Banka mbështeti dhe u solidarizua me aktin normativ të Bankës së Shqipërisë për të vlerësuar çdo klient, ekonomia

AAB AKTIVITETE

e të cilit është prekur drejtpërdrejt nga pandemia dhe e ka të pamundur të shlyejë në kohë këstet e huas. Po ashtu, paga e luftës solli pranë degëve të Tirana Bank një fluks të madh klientësh për të hapur llogaritë e tyre. Me profesionalizëm të plotë degët ju përgjigjen çdo kërkesë, duke respektuar të gjitha masat e higjienës.

- Më datë 15 prill, Tirana Bank firmosi me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Marrëveshjen për Garancinë Sovrane, që do të përdoret për të mbuluar financimin e fondit të pagave që bizneset do të marrin pranë Tirana Bank.
- Tirana Bank i ofroi të gjithë klientëve biznes dhe retail, përdorimin e platformës winbank, me kushte preferenciale, si një platformë shumë e sigurt në këtë kohë pandemie. Me përdorimin e saj çdo klient mund të transferojë fonde nga llogaria e tij në një llogari në një bankë tjetër, pa komision.
- Situata e krijuar vuri në qendër të vëmendjes kategorinë e "Heronjëve të Luftës", duke dizenuar një paketë preferenciale produktesh dhe shërbimesh, me kushte preferenciale dhe shërbime me komisione zero. Paketa e heronjve përfshinte: kredi konsumatore e pasiguruar, Overdraft, Paketa e Payroll-it, Depozita 25 mujore, Karta e Debitit, Karta e Kreditit, apo dhe shërbimet si: debitimi direkt dhe urdhër pagesa.

Aktivitetet e AAB-së, lidhur me Covid-19

Në kuadër të masave paraprake globale ndaj Coronavirusit, COVID-19, sektori bankar ishte ndër të parët që vendosi masat e sigurisë (shëndetësore), me qëllim mbrojtjen e shëndetit të klientëve dhe punonjësve, pavarësisht kostos që lidhej me to.

Në 17 mars, pas Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, urdhrat të përbashkët të Kryeministrit dhe Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, u autorizua një shtyrje tremujore e pagesës së kësteve të huave, për bizneset dhe individët, të cilët u përballën me vështirësi financiare, si rezultat i situatës së krijuar nga COVID-19. Masat për ri-skedulimin e kësteve të huave hynë në fuqi në 13 mars 2020. AAB koordinoi procesin e mbledhjes së të dhënave.

Disa banka kanë nxitur dhe promovuar përdorimin e kanaleve digjitale, përveç masës së shtyrjes së pagesave të kësteve të huave me tre muaj, duke hequr dorë nga komisionet e shërbimit online (home/mobile banking), si dhe për tërheqjen e parave nga ATM-të e bankave të tjera.

AAB bashkëpunoi me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, lidhur me instrumentin e Garancisë Sovrane, për bizneset e prekura financiarisht nga pandemia.

Në muajin maj, Shoqata Shqiptare e Bankave dhe Banka e Shqipërisë, në vijim të analizave dhe duke marrë parasysh propozimet e paraqitura nga bankat, si dhe bazuar në përvojat më të mira të vendeve të tjera dhe udhëzimet e nxjerra nga Autoriteti Bankar Europian (EBA),

miratoi disa ndryshime në rregullat e administrimit të rrezikut të kredisë nga bankat, kryesisht nëpërmjet:

- Pëzullimit të përkohshëm të zbatimit të detyrimeve që rrjedhin nga kërkesat për menaxhimin e rrezikut të kredisë për klasifikimin e huave dhe provizionimin e tyre, për të gjitha kategoritë e klientëve, për një periudhë shtesë, nga 1 qershori deri më 31 gusht 2020, për shkak të vështirësive financiare dhe përkeqësimit të aftësisë paguese të huamarrësve të prekur nga kjo situatë;

- Pëzullimit të përkohshëm të krijimit të fondeve rezervë për pasuritë e paluajtshme të marra kundrejt pagesës së huas, deri në dhjetor 2020;

- Miratimit të një dispozite lehtësuese për huatë e ristrukturuara, sipas të cilës bankave mund të ristrukturojnë marrëveshjet aktuale të huas, me qëllim gjetjen e zgjidhjeve të përshtatshme, pa përkeqësuar statusin e huamarrësve;

- Zgjatjes me 1 vit të hyrjes në fuqi e kërkesave më shtrënguese për klasifikimin dhe sigurimin e huave të ristrukturuara, deri në janar 2022; dhe

- Zgjatjen me 1 vit të efekteve të Rregullores: "Për trajtimin jashtëgjyqësor nga bankat, të kredimarrësve në vështirësi financiare", deri në janar 2022.

Ndërkohë, për huamarrësit, aftësia paguese e të cilëve nuk është prekur dhe dëmtuar nga kjo situatë, duhet të vazhdojnë të paguajnë normalisht detyrimet e tyre ndaj bankave.



Kryetari i AAB-së, Z. Silvio Pedrazzi merr pjesë në takimin me temë: "Marrëdhëniet Bankë - Biznes: Sfidat e përbashkëta ekonomike përballë pandemisë globale Covid-19"

Më 13 maj 2020, Banka e Shqipërisë organizoi një forum diskutimesh me sistemin bankar dhe komunitetin e biznesit. Në fjalën e mbajtur në këtë takim, Z. Silvio Pedrazzi, Kryetar i Shoqatës Shqiptare të Bankave dhe Drejtor i Përgjithshëm i Intesa Sanpaolo Bank Shqipëri, vuri në dukje përgjegjësinë, profesionalizmin dhe angazhimin e sektorit bankar në këtë situatë të jashtëzakonshme. Ai nxori në pah disa nga sfidat me të cilat përballet sektori bankar në realitetin e ri, për të mbështetur huamarrësit

në nevojë, pa kompromentuar kriteret e huas dhe duke ruajtur qëndrueshmërinë e bilanceve të bankave.



Mëngjes pune me Drejtorin e Përgjithshëm Ekzekutiv të AMF-së
Z. Silvio Pedrazzi, Kryetar AAB-së dhe Drejtor i Përgjithshëm i Intesa Sanpaolo Bank Shqipëri, i shoqëruar nga disa drejtorë të bankave tregtare, ofroi një mëngjes biznesi me Z. Ervin Mete, Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AFSA) dhe përfaqësues të tjerë të institucionit. Gjatë takimit u diskutuan çështje të ndryshme ligjore.

Përfaqësuesit e AMF-së dhe AAB-së treguan gatishmëri për të bashkëpunuar dhe organizuar veprimtari të përbashkëta, në kuadër të edukimit financiar, për të gjithë pjesëmarrësit e tregut financiar.

Takim – diskutimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve

Në 25 qershor u mbajt një takim – diskutimi mbi shkëmbimin automatik të informacionit për llogaritë financiare. Pas shqetësimeve të ngritura nga disa banka, AAB dhe DPT organizuan takimin online, me fokus kryesisht në çështjet e TIK.

Takim – diskutimi me Bankën e Shqipërisë

Më 19 qershor, në bashkëpunim me Departamentin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme të Bankës së Shqipërisë dhe me kërkesën e bankave, u organizua një takim – diskutimi online, lidhur me projekt rregulloren: "Për kërkesat minimale për instrumentet e kapitalit rregullator dhe detyrimet e pranuar".

TRAJNIME

AAB organizon trajnime Prill - Qershor 2020

Analiza e rrezikut të kredisë dhe rrjedhës së parasë, i organizuar nga AAB dhe ATTF Luksemburg në 13 - 14 maj dhe 20-21 maj 2020.

Menaxhimi i kohës dhe produktiviteti, i organizuar nga AAB dhe Lincoln Center, në 14 - 15 maj.

Aspekte pozitive të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve jashtë gjykatës për zgjidhjen e paaftësisë paguese – Ngritja e ndërgjegjësimit të Komunitetit të Biznesit, i organizuar në 14 maj nga IFC, në bashkëpunim me AAB dhe me mbështetjen e Ambasadës Zvicerane.

Menaxhimi dhe mjeshtëritë për shitjet. Më 2 - 3 & 9 - 10 qershor, AAB, në bashkëpunim me AIEx, organizoi për herë të parë trajnimin online në gjuhën shqipe në platformën LMS.

Drejt Realitetit të Ri – Zhdërvjelltësia e Lidershipit. Më 23 - 24 qershor, i organizuar në bashkëpunim me AIEx.

Krijimi i një kulture të angazhimit të punonjësve. Më 26 qershor, u organizua një takim – diskutimi në internet me Dr. Larissa Winter, që u mbështet nga AAB, DIHA dhe AIEx.

Më 7 maj, AAB publikoi **Kalendarin e mësimit në distancë të ATTF - House of Trainings**, si dhe bëri të mundur pjesëmarrjen e punonjësve të sistemit bankar në trajnimet përkatëse virtuale dhe kurset e mësimit elektronik, falë mbështetjes financiare të Qeverisë së Luksemburgut.

